



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
TIRANË

NR. AKTI 636

NR. VENDIMI 2316



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË

NR. 636 AKTI  
NR. 2316 VENDIMI  
Dt.Rregj 10.11.2020  
Dt.28.07.2021

**V E N D I M**  
**‘NË EMËR TË REPUBLIKËS’**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

Gjyqtarit: ARBEN MICKAJ  
Gjyqtarit: SOKOL TONA  
Gjyqtares: ARDIANA BERA

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Merita Drishti**, sot me datë **28.07.2021**, mori në shqyrtim ne seance gjyqësore publike çështjen penale me nr. 636 akti dhe datë ardhje 10.11.2021, në ngarkim:

**KËRKUESE:**  
Tirane përfaqësuar

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

nga prokurore **Anila Galanxhi**

**Pappa.**

**PANDEHUR:**

**ANJEZA BENA:** identifikuar me ID H66207037 F, e bija Xhemalit dhe e Lumturise, dtl. 07.12.1976, lindur dhe banuese ne Tirane, Rruga Islam Alla, nr. 59/1, e divorcuar, me tre femije, me arsim te larte, e padenuar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga av. Baftjar Rusi, me deklarim ne seance gjyqesore.

**I AKUZUAR:**  
prostitucionit”, te

Për kryerjen e veprës penale të “**Shfrytezimi i**

parashikuar nga **neni 114/2 i**

**K.Penal.**

**ANA SULA:**identifikuar me ID,

nr. I75909047 U, e bija e Arjanit dhe e Flutures, dtl. 09.09.1987, lindur dhe banuese ne Tirane,Rruga Halil Bega, pallat i vjeter 2 katesh, shk.2, ap.2,beqare, me arsim te larte,e padenuar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga av. Andi Hasanaj, me licence nr.6828, me deklarim ne seance gjyqesore, si dhe me prokure te posacme nr.6618 rep., nr.1480 kol., dt. 19.11.2019, te noteres Xhevahire Brahaj.

**I AKUZUAR:**  
te parashikuar nga

Për kryerjen e veprës penale të “**Prostitucioni**”,

**neni 113/1 i K.Penal.**

**ISMAIL ZANI:**i biri i Hajderit

dhe i Hankes, dtl. 21.04.1963,

lindur dhe banues ne Fier, lagja 1 maj, banese private, me arsim te mesem, i martuar, i pa denuar me pare, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, , mbrojtur ne gjykim nga av.Agron Kalemaj, me licence nr.1133, me prokure te posaçme nr. 1093 rep., nr.298 kol., dt. 12.10.2020, te noteres Adelina A. Panajoti(jo present ne shpallje).

**I AKUZUAR:**  
te parashikuar nga

Për kryerjen e veprës penale të “**Prostitucioni**”,

**neni 113/2 i K.Penal.**

**ARMANDO NUSHI:** i biri i Mitit dhe i Florikes, dtl. 12.04.1976, lindur ne Fier, banues ne Kanada, Quebec, me vendqendrim ne Shqiperi, ne adresen Tirane, Rruga Shyqyri Brari, p.3, ap.8, me arsim te mesem, beqar, i pa denuar me pare, me kombesi shqiptare, me shtetesi shqiptare dhe kanadeze, mbrojtur ne gjykim nga av.Olta Pema, me licence nr.6391 me prokure te posaçme nr.4253 rep., nr.1538 kol., dt. 15.11.2019, te noteres Romina Meli.

**I AKUZUAR:**  
te parashikuar nga

Për kryerjen e veprës penale të “**Prostitucioni**”,

**neni 113/2 i K.Penal.**

**HERMES NIKAJ:**identifikuar me ID J 10711080 E, i biri i Mariglenit dhe i Albines, dtl. 11.07.1991, lindur dhe banues ne Tirane, Rruga e Duresit, blloku i ambasadave, p.204, ap.83, beqar, me arsim te larte, i padenuar,me kombesi dhe shtetesi shqiptare, me mase sigurimi arrest ne shtepi, mbrojtur ne gjykim nga av.Perlat Koçillari, me licence nr.1207, me deklarim ne seance gjyqesore

**I AKUZUAR:**  
prostitucionit” dhe

Për kryerjen e veprës penale të “**Shfrytezimi i**

“**Prostitucioni**”, te parashikuar

nga neni 114/2, 113/1 i K.Penal.

**DENISA NELI:**identifikuar me ID J 95208036 F, e bija e Pellumbit dhe e Nafies, dtl. 08.02.1999, lindur ne Zall Here, Tirane, banuese ne Durres, banese prane hotel Palace, e martuar, me arsim 9 klase, e padenuar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga av.Edvis Gorishti, me licence nr.9537, me deklarim ne seance gjyqesore(jo present ne shpallje).

**I AKUZUAR:**  
te parashikuar nga

Për kryerjen e veprës penale të “**Prostitucioni**”,  
**neni 113/1 i K.Penal.**

**ARTUR GJINI:**i biri Pashkut dhe i Mrikes, i datelindjes 17.09.1972, lindur ne Selite, Kruje, banues ne Mamurras,Kurbin, lagja Demokracia, banese private nje kateshe pa numer, i martuar , i pa denuar me pare, me arsim te mesem, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga av. Elton Hyseni, me licence nr.2790, me prokure te posacme nr.1720 rep., nr.1356 kol., dt.23.10.2020, te noteres Ernita A.Haxhiu.

**I AKUZUAR:**  
te parashikuar nga

Për kryerjen e veprës penale të “**Prostitucioni**”,  
**neni 113/2 i K.Penal.**

**BLERTA DUKA:**e bija e Rakipit dhe e Mireles, dtl. 14.09.1997, lindur dhe banuese ne Tirane, rruga “Nikolla Lena”, banese private nr.15, prane spitalit “Gjerman”, me arsimi te mesem, beqare, e padenuar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga av.Aldor Hysenlikaj, me licence nr.8850, me deklarim ne seance gjyqesore.

**I AKUZUAR:**  
te parashikuar nga

Për kryerjen e veprës penale të “**Prostitucioni**”,  
**neni 113/1 i K.Penal.**

Në perfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të prokurores Anila Galanxhi Pappa si dhe mbrojtjes te të pandehurve dhe te pandehurit, gjykata dhe pasi shqyrtoi aktet dhe si dëgjoi akuzën së bashku me perfaqsesin e të pandehurit, të cilët në konkluzionet përfundimtare kërkuan respektivisht:

**PROKURORI:**

1. Deklarimin fajtor të të pandehurës Anjeza Bena, për veprën penale “Shfrytëzimi i prostitucionit” parashikuar nga neni 114/2 i K.Penal, dënimin e saj me 7 vjet e 6 muaj burgim.
2. Gjykata në caktimin e dënimit duhet të aplikojë dhe nenin 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me 5 vjet burgim.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurës Ana Sula, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e saj me 6(gjashtë) muaj burgim.
4. Gjykata në caktimin e dënimit duhet të aplikojë dhe nenin 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me 4 (katër) muaj burgim.
5. Në zbatim të nenit 113/1 të Kodit Penal dhe 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej 8(tetë ) muaj , me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale .
6. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ismail Zani, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal, dënimin e tij me 6 (gjashtë ) muaj burgim.
7. Gjykata në caktimin e dënimit duhet të aplikojë dhe nenin 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me 4(katër) muaj burgim.
8. Në zbatim të nenit 113/2 të Kodit Penal dhe 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej 8 (tetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale .
9. Deklarimin fajtor të të pandehurit Armando Nushi, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal, dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.
10. Gjykata në caktimin e dënimit duhet të aplikojë dhe nenin 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me 4 (katër) muaj burgim.
11. Në zbatim të nenit 113/2 të Kodit Penal dhe 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej 8 ( tetë) muaj , me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale .
12. Deklarimin fajtor të të pandehurit Hermes Nika, për veprën penale “Shfrytëzimi i prostitucionit” parashikuar nga neni 114/2 i K.Penal, dënimin e tij me 7 vjet e gjashtë muaj burgim.
13. Deklarimin fajtor të të pandehurit Hermes Nikaj, për veprën penale “Prostitucioni ” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e tij me 6(gjashtë) muaj burgim.
14. Në aplikimin e nenit 55 të Kodit Penal bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm duke e dënuar me 7 vjet e 6 muaj burgim.
15. Gjykata në caktimin e dënimit duhet të aplikojë dhe nenin 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me 5 (pesë) vjet burgim.
16. Deklarimin fajtor të të pandehurës Denisa Neli, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e saj me 6 (gjashtë) muaj burgim.
17. Gjykata në caktimin e dënimit duhet të aplikojë dhe nenin 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me 4(katër) muaj burgim.

18. Në zbatim të nenit 113/1 të Kodit Penal dhe 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej 8 (tetë) muaj , me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale .
19. Deklarimin fajtor të të pandehurit Artur Gjini, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal, dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.
20. Gjykata në caktimin e dënimit duhet të aplikojë dhe nenin 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me 4 (katër) muaj burgim.
21. Në zbatim të nenit 113/2 të Kodit Penal dhe 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej 8 (tetë) muaj, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.
22. Deklarimin fajtor të të pandehurës Blerta Duka, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e saj me 6 (gjashtë ) muaj burgim.
23. Gjykata në caktimin e dënimit duhet të aplikojë dhe nenin 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me 4 (katër) muaj burgim.
24. Në zbatim të nenit 113/1 të Kodit Penal dhe 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej 8 (tetë ) muaj , me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.
25. Në bazë të nenit 190/1 i Kodit të Proçedurës Penale provat materiale të sekuestruara të kthehen dhe perzervativët të azgjeshohen.
26. Shpenzimet procedurale të hetimit paraprak dhe ato të gjykimit,t'i ngarkohen të pandehurit.

**1-Mbrojtja e te pandehures Anjeza Bena**, av. Baftjar Rusi paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates:

- qe te aplikohet si mase denimi per te pandehuren minimum i dispozites penale te sanksionuar ne nenin 114 te K.Penal dhe aplikimin e nenit 59 te K.Penal mbi masen e denimit.

**2- Mbrojtja e te pandehures Ana Sula**, av. Andi Hasanaj paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;

- nje mase denimi sa me te bute, pezullimin e ekzekutimit te vendimit me burgim dhe detyrimi per kryerjen e nje pune ne interes publik, bazuar kjo ne nenin 63 te K.Penal.

**3- Mbrojtja e te pandehurit Ismail Zani**, av.Agron Kalemaj paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;

- ne aplikim te nenit 388/d te K.Pr.Penale, deklarimin e pafajshem te te pandehurit Ismail Zani pasi nuk provohet qe i pandehuri te kete kryer vepren penale ose ne alternative te ketij denimi ne rast se gjykata e gjen fajtor denimi me gjob ne masen 100.000 leke.

**4- Mbrojtja e te pandehurit Armando Nushi**, av.Olta Pema paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;

- deklarimin e pafajshem te shtetasit Armando Nushi, ne alternative te denimit kerkojme denimin e tij me gjobe ne nje mase te cmuar nga gjykata.

**5- Mbrojtja e te pandehurit Hermes Nikaj** av.Perlat Kocillari paraqet me shkrim

konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;  
-bazuar ne nenin 388/1,d te K.Pr.Penale pafajsi per te pandehurin Hermes Nikaj pasi nuk provohet se ai ka kryer veprat penale per te cilat akuzohet, ne rast se nuk pranohet kerkojme aplikimin e Nenit te 59 te K.Penal.

6- **Mbrojtja e te pandehures Denisa Neli**, av.Edvis Gorishti paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;

- kerkon nje mase me te bute

7- **Mbrojtja e te pandehures Artur Gjini**, av.Entela Hyseni paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;

-denimin e te pandehurit me nje gjobe minimale, ose ne alternative denimin e tij ne nje mase minimale me burg dhe te aplikojte nenin 63 te K.Penal per pjesen e pavuajtur te denimit me burg duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim per Artur Gjini dhe zevendesimin e tij duke kryer nje pune ne interes public.

8- **Mbrojtja e te pandehures Blerta Duka**, av.Aldor Hysenlikaj, paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;

- kerkon pezullimin e denimit duke aplikuar nenin 59 te K.Penal dhe venien e tij ne prove.

Dhe si shqyrtoi ceshtjen ne teresi

## V E R E N

Se nga organi i Prokurorise prane kesaj gjykate eshte sjelle per gjykim ceshtja penale me

Nr. 636 Akti dhe date ardhje 10.11.2020, ne ngarkim te te pandehurve **Anjeza Bena**, e akuzuar

per vepren penale te "**Shfrytezim prositucioni**", e parashikuar nga neni 114/2 te K.Penal, te

pandehures **Ana Sula**, e akuzuar per vepren penale te "**Prositucion**", e parashikuar nga neni 113/1

e K.Penal, te te pandehurit **Ismail Zani, Armando Nushi**, te akuzuar per vepren penale te "**Prositucion**", e parashikuar nga neni 113/2 e K.Penal, te te pandehurit Hermes Nikaj, i akuzuar

per veprat penale te "**Shfrytezim prositucioni**" dhe "**Prositucion**", te parashikuar nga nenet 114/2 e 113/1 te K.Penal, te pandehures Denisa Neli, akuzuar per vepren penale te "**Prositucion**",

e parashikuar nga neni 113/1 te K.Penal, te te pandehurit **Artur Gjini**, i akuzuar per vepren penale te "**Prositucion**", e parashikuar nga neni 113/2 te K.Penal dhe te te pandehures **Blerta Duka**, e akuzuar per vepren penale te "**Prositucion**", e parashikuar nga neni 113/1 te K.Penal

Gjate seancës paraprake, nga ana e të pandehurve, të asistuar nga mbrojtësit e tyre, kanë kërkuar aplikimin e procedurave te rritit te gjykimit te shkurtuar, duke njohur vleren e akteve, kerkese me te cilen ishte dakort edhe akuza.

Nga ana e Gjykatës me vendimin nr. 2341 akti, datë 30.10.2020 në vleresimin qe u beri akteve te paraqitura nga Prokurori, ajo vendosi që gjykimi duhet zhvilluar në mbështetje të procedurave te parashikuara nga Nenet 403 - 406 te Kodit Proçedures Penale duke pranuar keshtu kerkesen e te pandehurit.

Pas parashtrimit ne menyre sintetike te rezultateve te hetimit paraprak e dhenies se pelqimit nga i pandehuri se e pranonte vleren e akteve qe kerkoj te administroheshin si prova nga organi i akuzes, per vete parashikimin perjashtimor qe ben ligji kur aplikon proçedurat e gjykimit te shkurtuar, nga kjo gjykate u administrua ne teresi fashikulli i proçedimit penal Nr.

324 i vitit 2019.

Nga shqyrtimi gjyqesor i kesaj çeshtje, rezulton sa vijon: Në bazë të materialeve të referuara nga Seksioni për Trafiket e Paligjshme në D.V.P. Tiranë, Pokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 324 i vitit 2019 për veprat penale “Prostitucioni” dhe “Shfrytëzimi i prostitucionit” parashikuar nga nenet 113 dhe 114 të Kodit Penal.

Për dokumentimin e kësaj veprimtarie është autorizuar kryerja e përgjimit të fshehtë fotografik, filmik ose me video në vende publike për interes të hetimeve të procedimit penal nr. 324 të vitit 2019, nga data 11.02.2019 deri në datë 25.02.2019, 15.03.2019 deri në datë 29.03.2019, 19.06.2019 deri në datë 03.07.2019, nga data 04.07.2019 deri në datë 19.07.2019, nga data 20.07.2019 deri në datë 03.08.2019, nga data 14.10.2019 deri në datë 28.10.2019, nga data 29.10.2019 deri në datë 12.11.2019 dhe nga data 13.11.2019 deri në datë 28.11.2019.

Me kërkesat përkatëse, organi i akuzes i është drejtuar Seksionit të Operacioneve Speciale në D.V.P. Tiranë për mbikqyrjen e fshehtë dhe fotografimin, filmim me video në vende publike të shtetasit Hermes Nikaj, Anjeza Bena dhe Floresha Sula.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimet nr. akti 60 datë 19.06.2019, nr. akti 60/1 datë 04.07.2019 dhe vendimin nr. 60/2 datë 19.07.2019, ka vendosur lejimin e përgjimit telefonik për numrin e telefonit 0696983895 në përdorim të shtetasit Hermes Nikaj. Me vendimin nr. 93 akti datë 15.10.2019, nr. 93/1 datë 30.10.2019 dhe 93/2 akti datë 14.11.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lejimin e përgjimit të komunikimeve telefonike për numrat e telefonit 0696983895 (Hermes Nikaj), 0692571295 (Floresha Sula) dhe 0696701171 (Anjeza Bena).

Nga veprimet hetimore të kryera dhe shqyrtimi në tërësi i materialeve të procedimit penal, në disa episode të dokumentuara edhe nëpërmjet mjeteve e metodave speciale të hetimit, shoqëruar me raporte vëzhgimi, pamje filmike të hedhura në CD e foto të personave e momenteve të kryerjes së veprimtarisë së kundërligjshme, kqyrje, sekuestrime dhe deklarimeve të shtetasve dhe ka rezultuar si më poshtë:

Në bisedat e transkriptuara të datës 20.07.2019 ora 10:48’ shtetasia Anjeza Bena ka telefonuar shtetasin Hermes Nikaj, ku këtij të fundit i kërkon 1 ose 2 vajza duke përdorur termin “Sfilatë” dhe thotë se ka një rast shumë të mirë. Në vijim të kësaj bisede Anjeza i kërkon Hermesit të shikojë për ti gjetur ndonjë “p.” që nënkupton vajza, pasi i do për qejf dhe përmend emrat Kejsi dhe Arba. Anjeza shprehet se nuk ka pasur ndonjë fitim prej vajzave, ndërsa Hermesit thotë Anjezës se ju bëjnë nderë këtyre femrave të cilat kryejnë seks dhe bëjnë qejf.

Nisur nga kjo bisedë është vendosur në interceptim numri 0696701171 i cili i përket shtetasit Anjeza Bena.

Në datë 16.10.2019 Anjeza zhvillon një bisedë telefonike me shtetasin Ismail Zani me numër telefoni 0698382899 që gjatë bisedave del dhe me emrin Çesku, Ismaili i kërkon Anjezës një vajzë pasi do të shkojë në Athinë dhe do ta mbaj me vete. Anjeza i thotë Ismailit që të mos e mbaj mendjen tek **Blerta** pasi ajo nuk shkon, por do të flasi dhe do ti kthej përgjigje.

Në vijim të bisedave të zhvilluara mes personave nën hetim Anjeza Bena dhe Ismail Zani, Anjeza i tregon Ismailit se i ka thënë njëres por ajo i ka kërkuar 500 euro. Në bisedën e datës 27.10.2019 Anjeza i thotë Ismailit se ndodhet me mikeshën e saj Anën, vajza e cila do të

shkoj tek Ismaili në Fier dhe më pas do të shkojnë sëbashku në Stamboll ku do të qëndrojnë tre ditë . Gjatë bisedës Anjeza përmend Xhixhon ku del se ky i fundit i ka thënë Anjezës ta marr vetë në telefon Ismailin. Në datë 28.10.2019 Anjeza bisedon përsëri me Ismailin në lidhje me vajtjen e Ana Sulës, tek ky i fundit. Po në këtë datë Anjeza flet me Ana Sulën ku bisedojnë në lidhje me vajtjen e Anës tek Ismailin, ku gjatë bisedës Anjeza i thotë “*Kurt ë duash, foli Xhixho, nuk do rroba i tha Xhixho. I than ë syrin tim se s'kena fol, do lek tha. Mir tha. Po patjetër. Dhe i tha po të vij ky qorri. Qorri tha ta pëlqej... I tha kjo ti blej gjonat o lek edhe të merren vesh*”. Gjatë bisedës Ana i thotë Anjezës: “*Ej, po pse si tha, vetëm për 500 tha?*”, dhe Anjeza i thotë Anës: “*Jo, jo, nuk do rroba I tha Xhixho. Do pesëqindshen, nuk do roba, i do lekë*”. Ana thotë: “*Çar tha?*”, Anjeza: “*Po tha*”.

Në datë 29.10.2019 Ana dhe Anjeza bisedojnë përsëri në telefon mes tyre Anjeza i thotë Anës ti kërkoj atij (Çeskut) që ti blej Anës 200 euro rroba. Gjatë kësaj bisede Anjeza i tregon Anës se sit ë sillet me Çeskut, ndërsa Ana e pyet Anjezën nëse do të vi jai tjetri në hotel (person tjetër përveç Çeskut) apo do e mbaj vetëm Çesku, Anjeza i thotë Anës se nëse personi tjetër do të shkoj atëherë Ana të kapi direkt pesëqindshen në dorë. Ana e pyet Anjezën nëse personi do i jap më tepër se 500 dhe Anjeza i thotë 500 dhe lekët e rrobave. Biseda mes tyre vijon në këtë kontekst. Po në këtë datë Anjeza flet në telefon me Ismailin (Çeskun) të cilit i thotë se me Anën do të kënaqet pasi është si braziliane dhe Anjeza e ka pasur kursante dhe e njeh. Anjeza i tregon Ismailit se nuk duhet ta ketë merak Anëns, pasi ajo është e pastër dhe nuk mban era djers. Anjeza i krahason Ismailit (Çeskut) Anën, me Kejsin ku i thotë se “*Është e pastër tamam si puna e Kejsit*”. Në datë 30.10.2019 ora 09:43’ Anjeza flet me Ismailin në telefon ku gjatë bisedës i tregojnë Anjezës se ndodhen në doganën e Kakavijes dhe janë të kënaqur.

Në datë 02.11.2019 Anjeza bisedon në telefon me Ana Sulën, ku kjo e fundit i tregon se si kaluar me Ismailin jashtë Shqipërisë. Gjatë bisedës Ana i tregon se Ismaili i ka dhënë vetëm lekët dhe s’ka bërë as shopin dhe nuk i ka blerë as parfumin Anjezës. Ana i tregon Anjezës se i kanë thënë se pot ë shkante me Gjergjin, Gjergji ta blen një makinë. Nga biseda mes tyre Ana i përcjell Anjezës pakënaqësi në lidhje me pagesën dhe kohën e kaluar me Ismailin (Çeskun).

Është bërë kqyrja e sistemit TIMS me qëllim marrjen e të dhënave për momentin e kalimit të shtetasve të mësipërm në pikën e kalimit kufitar Kakavije ka rezultuar se në orën orën 09:40’ të datës 30.10.2019 kanë dalë nga R. Shqipërisë me përsorues “*BISTRIO*”, shtetasit:

- 1- **Ismail Hajder Zani**, i dtl. 21.04.1963, me nr. dokumenti BB1120965, me autoveturë me targë AA681TK, ka qënë shofer, me numër rendor në listë 124.
- 2- **Ana Arjan Sula**, e dtl. 09.09.1987, me nr. dokumenti BF0442745, me autoveturë, nuk ka qënë shofere, me numër rendor në listë 125.
- 3- **Gjergji Pandeli Marini**, i dtl. 30.11.1976, me nr. dokumenti BR6884082, me autoveturë, nuk ka qënë shofer, me numër rendor në listë 126.
- 4- **Andi Dhimitri Papa**, i dtl. 18.07.1980, me dokument nr. AM 787471 shteti Greqi, me autoveturë, me numër rendor në listë 41.

Në datë 01.11.2019 ora 19:09’ rezulton se kanë hyrë në R.Shqipërisë nga P.K.K. Kakavije Gjirokastër me autoveturë me targë AA681TK, shtetasit:

- 1 - **Andi Dhimitri Papa**, i dtl. 18.07.1980, me dokument nr. AM 787471 shteti Greqi, i cili ka qënë shofer i këtij automjeti.
- 2- **Ismail Hajder Zani**, i dtl. 21.04.1963, me nr. dokumenti BB1120965, me autoveturë me targë AA681TK, ku ka qënë pasagjere në këtë automjet.
- 3- **Ana Arjan Sula**, e dtl. 09.09.1987, me nr. dokumenti BF0442745, me autoveturë me



targë AA681TK, ku ka qënë pasagjere në këtë automjet.

Në datë 08.11.2019 Anjeza Bena bën një bisedë telefonike me shtetasen Ana Sula, të cilën po e përshkruajmë të përmbledhur si më poshtë:

255: Ça po bën?

171: tani unë mendova...për 2 orë bëhsh dot gati ti me u la me u kref

255: O zemra ime unë s'jam bo gati fare..

171: ...në orën 8.. darkën ora 6

255: O zemra ime po unë jam me atlete... shpirt

171: Pse mi nuk u vishke dot ti, ti s'po del për qejfin tim

255: O Anjeza pot i pse ma le në minut të funit

171: O Ana... në orën 6 të kam çu foto Mandi Kanada shifë orën

255: Po pra po ky a e njoh unë se mos është noj një që e njoh me tatuazhe

171: ...kare ta njof e tët them se njef

255: O q.. ropt

171: ... Kanada mi ka dy ditë që ka ardh dhe ka shpinë e vet ke liqeni ke Tiku Mato andej lart

255: E ça I the ti për fustanin

171: Po mirë pra se është shumë i respektueshëm se i kam çu dhe herë tjetër p.. unë kti para 2 viteve. Është super edhe më tha gjejm... të ikim të hamë një darkë... shpia ime se nuk është hoteleve.. lokaleve...2 orsh...mer taksinë ta sjell....

255: Okej mirë hajde

171: Unë njof p... e motrës, kam 3 në linjë tani që më thonë Anjeza na gjej noj gjë

255: Mirë mirë okej hajde

171: Unë nuk rri...baxhella... kurva.. merr noj njeri që tja vlej mos merr..

255: ... Anjeza për nja 2 – 3 orë jam gati

171: ...vi të marr unë

255: Te shpia pra se kam bër llafe me të shpisë...

Më pas zhvillohet përsëri një bisedë telefonike mes Anës dhe Anjezës, ku Anjeza bisedon me nënë e Anës Fluturën, të cilës i thotë se Ana do qëndrojë sonte tek Anjeza.

Nisur nga këto biseda është organizuar shërbimi sëbashku me Seksionit e Operacioneve Speciale dhe në rrugën "Myslym Shyri" pranë banesës së shtetasen Anjeza Bena është konstatuar i parkuar automjeti Mercedes Benz me ngjyrë gri me targë AA866JM. Rreth orës 23:38 në rrugën e Liqenit të Thatë është konstatuar automjeti tip BMW X1, me ngjyrë gri me targë AA703TM ku brenda saj ndodhej drejtuesja e mjetit Anjeza Bena, shtetasia Ana Sula e ulur në vendin e parë të pasagjerit dhe në sediljen e pasme ndodhej shtetasi Armando Nushi. Shtetasi Armando Nushi pasi ka zbritur nga mjeti është futur në një dyqan ku ka blerë ujë dhe RedBull dhe më pas është kthyer në makinë. Më pas kanë vazhduar lëvizjen dhe janë futur në rrugën "Peti" dhe kanë ndaluar para pallatit "Iri", ndërtesa nr.5, hyrja nr.2 dhe në orën 23:40' kanë zbritur nga mjeti shtetasit Ana Sula dhe Armando Nushi dhe janë futur në hyrjen e pallatit të sipër cituar kati 3 dhe më pas në apartamenti nr.17. Shtetasia Anjeza Bena ka vijuar lëvizjen në drejtim të rrugës së "Kavajës" ku dhe është ndjekur pa ndërprejre nga ana jonë. Në orën 00:00' të datës 09.11.2019 është bërë bllokimi i automjetit BMW me targë AA703TM sëbashku me shtetasen Anjeza Bena e cila është shoqëruar për veprimetë mëtejshme në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Në orën 00:17' nga ana jonë jemi afruar në derën e apartamentit nr.17 ku hyrën më parë shtetasit Ana Sula dhe Armando Nushi, banesë e cila është mbajtur në mbikqyrje pas hyrjes së këtyre personave. Në momentin e afrimit kemi dëgjuar zhurma që vinin nga brenda apartamentit, kemi trokitur në derën e

banesës dhe nga brenda saj është dëgjuar zëri i shtetasit Armando Nushi të cilit i kemi kërkuar të hap derën. Dera e apartamentit është hapur nga shtetasi Armando Nushi dhe pasi kemi thirrur “Policia” jemi futur brenda ku kemi konstatuar në korridor shtetasin Armando Nushi dhe në dhomën e gjumit shtetasen Ana Sula e cila ishte e zhveshur plotësisht. Në dyshtemenë e dhomë së gjumit janë gjetur 2 (dy) prezervativë të përdorur, dhe 2 amaballazhe prezervativësh të hapur me ngjyrë bojqielli dhe të kuqe ku njëri ndodhej në dyshteme dhe tjetri mbi komodinë. Personat e sipër përmendur janë shoqëruan për në ambiente e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për veprime të mëtejshme hetimore dhe proceduriale. Shtetasia Ana Sula kishte me vete 1 (një) çantë të vogël lëkure me ngjyrë të zezë, 1 aparat celular iPhone Xmax, 1 (një) kartëmonedhë 1000 lek dhe një buzëkuq. Është bërë kqyrja e banesës me ekspert kriminalist si dhe është bërë kontrolli i i banesës ku gjatë kontrollit nuk janë gjetur sende të kundraligjshme.

Në momentin e konstatimit shtetasia Anjeza Bena kishte me vete vetëm një aparat celular iPhone model A1784 me numër 0692464646 i cili nuk hapej ku nxirrte opsionin se donte disa minuta kohë të vendosje pinin e hapjes. Në lidhje me aparatën celular nr. 0696701171 sqaroi se e ka në banesën e saj.

Pranë ambienteve të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë është paraqitur vajza e shtetasen Anjeza Bena, Alesia Rushiti sëbashku me motrën e Anjezës shtetasen Majlinda Bena. Shtetasen Alesia Rushiti i është kërkuar nga ana jonë të na vendos në dispozicion aparatën celular me numër 0696701171, kërkesë e cila është pranuar. Sëbashku me një shërbim patrulle “Shqiponja” është kaluar nga ana jonë tek banesa e shtetasen Anjeza Bena e vajzën e zaj Alesia Rushiti, ku kjo e fundit nga ka dorëzuar aparatën celular iPhone me numër 0696701171.

Është pyetur si person që ka dijeni, shtetasia **Alesia Rushiti** e cila ka sqaruar se;..... nëna e saj Anjeza në datë 08.11.2019 rreth orës 14:00’ ka vajtur në punën e saj qendër estetike dhe më pas është kthyer në shtëpi në orën 21:00’. Pas orës 21:00’ Anjeza ka dalë nga shtëpia pasi do darkonte diku, ku i ka thënë Alesias se do të dilte me dy shoqe të saj. Po atë ditë Alesia sqaron se ka vajtur në shtëpinë e saj një shoqe e Anjezës me emrin Ana e cila është larguar më pas. Sipas saj Ana ka qëndruar 5 minuta dhe kanë biseduar me njëra tjetrën dhe më pas është larguar. Në lidhje me numrat e telefonit që përdor Anjeza, Ana ka sqaruar se përdor 2 aparat celular dhe konkretisht 1 aparat të cilin e ka për punë të qendrës estetike i cili është Iphone 6 me ngjyrë të bardhë me buton të dëmtuar dhe ekran të thyer i cili ka numrin 0696701171 dhe aparatën tjetër Iphone 7+, me ngjyrë të zezë me numër 0692464646. Në lidhje me aparatën celular me numër 0696701171 Alesia ka sqaruar se Anjeza e ka lënë në shtëpi pasi e ka për punë dhe nuk e merr me vete. Aparatën celular Iphone 6 me ngjyrë të bardhë me buton të dëmtuar dhe ekran të thyer i cili ka numrin 0696701171 në gjendjen siç e ka lënë mami, Alesia sqaron se na e vë në dispozicion.

Nga ana e organit te akuzes është bërë kqyrje e aparatëve celular të shtetaseve Anjeza Bena, Ana Sula dhe Armando Nushi.

Është bërë kqyrja e aparatit celular të shtetasen Anjeza Bena dhe me interes u gjetën komunikime me numrin +355692524255 të shënuar me emrin “Ana Pushi” të cilat janë nga data 04.092019 deri në datën 08.11.2019. Një pjesë e këtij komunikimi është si më poshtë:

[8.11.19, 6:24:36 PM] 📞❤️: Ne 6 me miri

[8.11.19, 6:24:41 PM] 📞❤️: Ste dalin dy ore ty

[8.11.19, 6:24:45 PM] Ana Pushi 🌸: attached:  
00000300-AUDIO-2019-11-08-18-24-45.opus

[8.11.19, 6:24:52 PM] 🇦🇷❤️: Vij te marre une  
[8.11.19, 6:24:55 PM] 🇦🇷❤️: Me makin  
[8.11.19, 6:25:03 PM] 🇦🇷❤️: Dhe te con ai me taxi  
[8.11.19, 6:25:08 PM] 🇦🇷❤️: Nuk do jet xhixho  
[8.11.19, 6:25:15 PM] 🇦🇷❤️: Vetem une ti dhe ai  
[8.11.19, 6:25:22 PM] 🇦🇷❤️: Po ora  
[8.11.19, 6:25:28 PM] 🇦🇷❤️: Po pra  
[8.11.19, 6:25:38 PM] 🇦🇷❤️: Ka shpin e vet te liqeni  
[8.11.19, 6:26:00 PM] 🇦🇷❤️: Te marre une ham dicka pastaj ti rri sa te dush  
[8.11.19, 6:26:08 PM] 🇦🇷❤️: Ja themi dhe ne tavolin  
[8.11.19, 6:27:37 PM] 🇦🇷❤️: Po qe ta degjosh ti  
[8.11.19, 6:27:44 PM] 🇦🇷❤️: Joooo  
[8.11.19, 6:27:51 PM] 🇦🇷❤️: Jeto ne kanada  
[8.11.19, 6:27:53 PM] 🇦🇷❤️: Mandi  
[8.11.19, 6:28:07 PM] Ana Pushi 🌸: po kr nai foto  
[8.11.19, 6:28:13 PM] Ana Pushi 🌸: moj se r njoh un  
[8.11.19, 6:28:17 PM] 🇦🇷❤️: Jooooo  
[8.11.19, 6:28:21 PM] Ana Pushi 🌸: r ka pas njoft ashiku  
[8.11.19, 6:28:22 PM] Ana Pushi 🌸: ket  
[8.11.19, 6:28:23 PM] 🇦🇷❤️: Nuk e njef fare  
[8.11.19, 6:28:26 PM] 🇦🇷❤️: Jooo  
[8.11.19, 11:55:48 PM] Ana Pushi 🌸: fole ti  
[8.11.19, 11:55:50 PM] Ana Pushi 🌸: zmr  
[8.11.19, 11:55:53 PM] Ana Pushi 🌸: me ket

Eshtë pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime në prani të avokatit, shtetasia **Ana Sula** e cila ka sqaruar se;..... prej shumë vitesh nje shtetasen Anjeza Bena pasi ka punuar si kursante në qendrën estetike të saj e cila ndodhet në rrugën “Myslym Shyri”. Me Anjezën ka mbajtur kontakte të vazhdueshme si dhe është takuar vazhdimisht. Ajo sqaron se gjatë kohës që ka qënë në kurs tek Anjeza është ndarë me të dashurin dhe ndodhur në këtë situatë të vështirë ekonomike Anjeza i ka propozuar që të dilte me persona të njohur të saj. Pasi Anjeza e prezantonte me klientët Ana dilte me ta dhe shkonin në hotele ku ka kryer marrëdhënie seksuale. Pasi përfundonte me klientët, ka marrë pagesën e cila ka qënë zakonisht 500 euro. Në lidhje me situatën e sotme ku është gjetur në banesën sëbashku me shtetasin Armando Nushi, Ana sqaron se rreth orës 18:00 i ka telefonuar Anjeza nga numri i saj që e ka të shënuar në telefon me “Anjeza” dhe i ka kërkuar të bëhej gati pasi kishte ardhur një shok i Xhixhos nga Kanadaja dhe duhet të dilnit për darkë dhe më pas të shkonte tek me të. Sipas Anjezës ky person ishte serioz dhe kishte një shtëpi tek zona e Liqenit të Thatë pranë një restoranti të quajtur “Tiku dhe Mato” dhe duhet të dilnin. Ana sqaron se Anjeza i ka thënë që personi është super pasi i ka çuar dhe para dy vitesh femër. Në lidhje me pagesën që do të merrte për të vajtur me këtë person Ana e ka pyetur Anjezën se çfarë i ka thënë Anjeza personit për “fustanin” dhe Anjeza i është përgjigjur duke i thënë se ishte për mirë. Ana sqaron se ka pranuar të shkojë, por i kam thënë Anjezës se ka probleme me familjarët dhe më i duhej pak kohë të bëhet gati. Aja sqaron se më pas Anjeza ka biseduar në telefon me nënën e Anës Fluturën të cilës i ka thënë se Ana do të qëndronte tek shtëpia e Anjezës. Nëna e Anës ka rënë dakort dhe Ana rreth orës 21:00 ka mbëritur tek shtëpia e Anjezës, ku është takuar

Anjezën. Ana sqaron se Anjeza i ka thënë se do shkonim fillimisht të hanin një darkë me personin që Ana nuk e njihnte dhe nuk e kishte takuar më parë i cili quhej Mandi. Ana sqaron se Anjeza i ka thënë se ai do i jepte paratë dhe se do ta respektonte. Kanë hipur në makinë e Anjezës dhe kanë vajtur tek një lokal që ndodhet pranë gjimnazit “Petro Ninin Luarasi” ku kanë darkuar Ana, Anjeza dhe Armandi. Pasi kanë përfunduar darkën Ana sqaron se sëbashku me Anjezën dhe Armandin kanë hipur në makinën e Anjezës dhe kanë vajtur në zonën e Liqenit të Thatë tek pallati ku banonte Armandi. Pasi janë ndarë me Anjezën, Ana dhe Armandi janë futur në banesën ku Armandi banonte, ndërsa Anjeza është larguar. Më Ana sqaron se kanë vajtur në dhomën e gjumit ku Armandi ka nxjerr dy prezervativë dhe kanë kryem marrëdhënie seksuale me njëri - tjetrin. Pas disa minutash ka rënë dera dhe kanë menduar se mund të ishte ndonjë komshi që ishte shqetësuar prej tyre. Pasi Armandi ka hapur derën brenda është futur policia. Në lidhje me pagesën për këtë rast Ana ka sqaruar se do të merte 500 euro dhe për këtë gjë kishte biseduar Anjeza me Armandin. Ana ka sqaruar se nuk e di se çfarë do merrte Anjeza prej Armandit, por për këtë rast Ana duhet ti jepte Anjezës diçka në formën e parave ose të ndonjë dhurate. Pyetjes nëse në rastet të mëparshme Anjeza ju ka siguruar klientë për të kaluar natën me ta, çfarë pagesash i ka bërë Ana shtetases Anjeza Bena, ajo i është përgjigjur duke thënë se në pak raste mund ti ketë dhënë Anjezës 50 ose 100 euro nga paratë që ka marrë prej personit që i kishte gjetur Anjeza. Në disa raste i ka dhuruar parfume ose ndonjë dhuratë tjetër. Në lidhje me personat që i ka gjetur Anjeza për të kryer marrëdhënie seksuale, Ana ka sqaruar se jetonin kryesisht jashtë Shqipërisë dhe ajo nuk ka bërë biseda me ta për të mësuar se kush janë. Rasti i sotëm ka qënë i pari që i është dashur të shkoj në një banesë. Rastet e tjera kanë qënë në hotele jashtë qytetit të Tiranës.

Shtetasia **Ana Sula** është pyetur në lidhje me rastin kur dalë nga Republika e Shqipërisë në datë 30.10.2019 nga pika e kalimit kufitarë Kakavije me autoveturë, në orën 09:40'. Ajo ka sqaruar se;... në lidhje me këtë rast e ka telefonuar Anjeza e cila i ka treguar se një shok i Xhixhos i cili është i dashuri i Anjezës do të shkonte me dy shok në Turqi. Gjatë udhëtimit të tyre personi i njohur me emrin Çesku dëshironte të kishin një femër me vete për të cilën do të paguante. Anjeza i ka shpjeguar Anës se si duhet të sillej me personin e njohur me emrin Çesku, duke i bërë qejfin me qëllim që ai ta paguante diçka më tepër. Ka biseduar me Anjezën për rroba që duhet të merrja e cila e ka këshilluar të merte taka dhe rroba erotike. Sipas saj Anjeza i ka shpjeguar se Çesku ndodhej në qytetin e Fierit ku do i duhej të shkonte dhe të takohej me të. Më pas do të udhëtonin me makinën e tij nga Fieri në Kakavije, në Selanik ku do të qëndrote 1 natë dhe nga Selaniku në Stamboll. Anjeza i ka dhënë numrin e telefonit të Çeskut i cili është 0698382899 dhe kanë komunikuar. Ana sqaron se Çesku i ka thënë se duhet të niset në mëngjes në orën 06:00' me taksì dhe do të takoheshin në rrethrotullimin e Fierit. Pasi ka mbërritur në Fier Ana sqaron se është takuar me personin që e njeh me emrin Çesku i cili është rreth moshësh 50 vjeç, trup i shkurtër, me flokë gështenjë, me sy të çelët dhe kishte një autoveturë Mercedes Benz me targë AA681TK. Kanë marrë rrugës dhe dy shokë të Çeskut të cilët quhen Andi dhe Gjergji dhe kanë vajtur rreth orës 09:30' në Kakavije. Pasi kanë kaluar të gjithë sëbashku kufirin kanë udhëtuar pa ndalesa në drejtim të Stambollit. Në Stamboll kanë qëndruar në një hotel në Maltepe Aydınevler. Ana sqaron se ka qëndruar në një dhomë me personin e njohur me emrin Çesku, ndërsa Andi dhe Gjergji kanë qëndruar në dhoma më vete. Pasi kanë bërë pazar dhe shëtitur nëpër qytet, ditën e nesërme kanë udhëtuar të gjithë sëbashku për në Selanik. Kanë fjetur një natë në Selanik dhe të nesërmen Gjergji është ndarë pasi do të shkonte me avion në Belgjikë, ndërsa Ana, Çesku dhe Andi janë kthyer për në Shqipëri. Ana sqaron se në datë 01.11.2019 kur kanë hyrë në mbremje në Kakavije janë ndaluar dhe kontrolluar imtësisht nga policia kuftare. Më pas kanë vazhduar udhëtimin ku personi me emrin Andi ka ndaluar në Gjirokastër ndërsa Ana dhe Çesku kanë vijuar në drejtim të qytetit të Fierit. Në Fier Çesku i ka marrë një taksì Anës dhe ka mbërritur në Tiranë.

Pyetjes nëse Ana ka kryer mardhënie seksuale me personat e sipër cituar, ajo i është përgjigjur duke sqaruar se ishte porositur për Çeskun dhe nuk kishte punë me Andin dhe Gjergjin. Ka qëndruar në një dhomë me Çeskun dhe i është dashur ti ofroj shërbim seksuale Çeskut duke e masturbuar. Ditën e nesërme në mëngjes Çesku i ka dhënë 500 euro. Kjo ka qënë gjithçka që ka ndodhur. Ana ka sqaruar se banon me nënën e saj e cila është e sëmure dhe me dy gjyshërit e moshuar. Babai i ka braktisur që kur Ana ka qënë 2 vjeç dhe vëllai 6 muajsh. Ajo sqaron se është e vetmja që çoj të ardhura në shtëpi dhe përpiqem të mbaj familjen.

Pasi janë njohur me të drejtat e tyre, janë pyetur në prani të avokatëve shtetasit Anjeza Bena dhe Armando Nushi dhe nuk kanë pranuar të japin sqarime.

Është bërë sekuestrimi i autoveturës së shtetasës Anjeza Bena BMW X1 me targë AA703TM, aparatëve të saj celular dhe disa kartëmonedhave që asaj ju gjenden me vete. Është sekuestruar aparati celular i shtetasës Ana Sula si dhe janë sekuestruar 2 aparat celular të shtetasit Armando Nushi, dy amballazhe prezervativësh të gjetura në banesën në zonën e Liqenit të Thatë, si dhe disa kartëmonedha që ju gjetën këtij shtetasi.

Në këto kushte është marë si person nën hetim në gjendje të lirë shtetasia **Ana Sula** për veprën penale “Prostitucioni” parashikuar nga neni 113/1 i Kodit Penal, është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit **Armando Nushi** për veprën penale “Prostitucioni” parashikuar nga neni 113/2 i Kodit Penal, si dhe është ndaluar me inisiativë si e dyshuar për një krim shtetasia **Anjeza Bena** për veprën penale “Shfrytëzimi i prostitucionit” parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkurtim vendimi nr. 2526 akti datë 12.11.2019 ka vensour per personin nën hetim Armando Nushi masën e sigurisë “Detyrim për tu paraqitur në policine gjyqësore” dhe për personin nën hetim Anjeza Bena ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”.

Në lidhje me rastet e mësipërme në datë 17.01.2020 është paraqitur në ambientet e D.V.P. Tiranë shtetasi **Ismail Zani**, ku në prani të mbrojtësit të tij pasi është njohur me letrën e të drejtave është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime për veprën penale “Prostitucioni”, parashikuar nga neni 113/2 i Kodit Penal, pasi nga hetimi ka rezultuar se shtetasia Anjeza Bena i ka siguruar shtetasit Ismail Zani, shtetasen Ana Sula për prostitucion, ku me këtë të fundit Ismaili ka udhëtuar për jashtë Shqipërisë dhe e ka shpërblyer për shërbime seksuale. Shtetasi Ismail Zani ka sqaruar se është njohur me hetimet që do të zhvillohen ndaj tij dhe do të jap sqarime një moment tjetër.

Në datë 04.02.2020 është pyetur si person që ka dijeni shtetasi **Andi Papa** në lidhje me njohjen që ai ka me shtetasin Ismail Zani dhe faktin që ka udhëtuar me këtë shtetas në datë 30.10.2019 në drejtim shtetit Grek sëbashku me shtetasen Ana Sula dhe Gjergji Marini. Shtetasi Andi Papa ka sqaruar se;..... Ismailin e ka mik të familjes dhe e njeh prej vitesh. Andi sqaron se para dt. 30.10.2019 i ka telefonuar Ismaili dhe i ka thënë nëse kishte dëshirë të udhëtonte me të në Turqi pasi do të shkonte për të bërë pazar dhe do qëndronte për qejf. Duke qënë se ka qënë pa angazhime dhe ka pasur dëshirë të shikoja Stambollin, Andi ka pranuar. Në mëngjes të datës 30.10.2019, Ismaili ka ardhur nga Fieri në Gjirokastër me automjetin e tij sëbashku me një vajzë të cilën Andi sqaron se nuk e kishte parë më parë dhe më pas ka mësuar se quhej Ana. Anën, Ismaili ja ka prezantuar Andit si shoqen e tij. Pasi kanë marrë me vete dhe shtetasin Gjergji Marini shok i Ismailit kanë kaluar në Kakavije të katërt në makinë dhe kanë ikur në drejtim të Selanikut dhe më pas në Stamboll ku kanë

qëndruar në një hotel në një zonë periferike. Kanë marrë 2 dhoma ku Andi ka qëndruar në një dhomë me Gjergjin ndërsa Ismaili ka qëndruar me shoqen e tij Anën. Kanë dalë dhe kanë shëtitur në Stamboll ku kanë drekuar dhe darkuar sëbashku. Sipas Andit ditën e nesërme janë nisur nga Turqia, në Selanik dhe rreth mbrëmjes jemi futur në Shqipëri nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Kakavije. Andi ka zbritur në Gjirokastër dhe Ismaili sëbashku me Anën kanë vazhduar rrugën, ndërsa shtetasi Gjergji Marini ka qëndruar në Selanik dhe nuk erdhi me ne. Nga ana jonë Andi është pyetur nëse gjatë kohës që kanë qëndruar në Selanik sëbashku me Anën, Ismailin dhe Gjergjin, a i ka shpjeguar ndonjë detaj Ismaili në lidhje me Anën dhe arsyen pse e kishte marrë me vete. Në lidhje me këtë pyetje Andi ka sqaruar se Ismaili nuk ju ka treguar asgjë rreth Anës, thjesht ju ka thënë se është shoqja e tij. Andi ka sqaruar se në praninë e tij nuk ka vënë re që Ismaili ti jap para apo ti blejë ndonjë dhuratë Anës. Siç ka sqaruar dhe mësipër Ana ka qëndruar në të njëjtën dhomë me Ismailin dhe nuk ka pasur kontakte Andin dhe me Gjergjin.

Nga hetimet e këtij procedimi penal rezulton se vajza të cilat ka në lidhje për aktivitet të paligjshme të prostitucionit personi nën hetim Hermes Nikaj, janë gjithashtu lidhje e personit nën hetim Anjeza Bena për veprimtari të paligjshme të prostitucionit. Për këtë arsye rastet e këtyre vajzave po i përshkruajmë si më poshtë për të dy personat nën hetim Anjeza Bena dhe Hermes Nikaj.

Gjatë hetimit të këtij procedimi penal personi nën hetim Hermes Nikaj zhvillon biseda të shumta telefonike me persona të ndryshëm të cilët i kërkojnë femra për të kryer mardhënie seksuale kundrejt pagesës, biseda të cilat janë të pasqyruara të plota në transkriptimet telefonike si dhe në kqyrjen e apartit celular të personit në hetim Hermes Nikaj si dhe personave të hetuar apo arrestuar nga policia gjyqësore. Përveç sa më sipër Hermes bisedon me vajzat që ushtrojnë prostitucion, në lidhje me përgatitjen e tyre para se të shkojnë tek klientët, pagesat që do marrin, transportin drejt këtyre destinacioneve ku në shumë raste bëhen me taksist që njihen prej tyre. Ai pasi bisedon me personat dhe lë takim me ta, kontakton vajzat që ka në lidhje për prostitucion dhe i dërgon në këto adresa. Në disa raste Hermes i ka marrë vajzat sëbashku me klientët dhe kanë vajtur në hotele të ndryshme në qytetin e Tiranës. Hermes zhvillon biseda dhe për kryejen nga ana e tij të mardhënieve seksuale kundrejt pagesës me personat të ndryshëm.

Në datë 20.01.2020 është bërë kqyrja e pjesshme e aparatit celular të shtetasit Hermes Nikaj dhe konkretisht aplikacionit “Whats app”, komunikimeve që u gjenden me numërin e telefonit +355695685698 ku bashkëbiseduesi i shkruan Hermesin nëse ka ndonjë gjë të mirë dhe i kërkon një person me emrin Mela dhe chocco nëse vijnë. Hermesin i përgjigjet se është me një shoqe tjetër dhe i dërgon një fotografi të një vajze të zhveshur, të mbuluar në pjesën e gjoksit dhe me mbathje, i njëjti imazh që gjendet në komunikimet e shtetasit Hermes Nikaj dhe Artur Gjinit. Në vijim numri +355695685698 i shkruan Hermesin se “2 goca mplq nje gje e tille”. Në datë Në datën 23.11.2019 në orën 13:02 dërgohet mesazh me tekst nga numri +355695685698: “Kemi ndonje gje tbukur sot” dhe në orën 13:18’ Hermesin dërgohet një mesazh zanor në drejtim të numrit +355695685698, ku thotë: “ Po mo zemër kemi të vi unë, Mela, Esi. Po ti më thuj o zemër ça ore pak a shumë që unë ta di ta organizoj? ”

Në datë 31.01.2020 është paraqitur në ambientet e D.V.P. Tiranë shtetasi **Orgest Seitaj**, i cili është pyetur si person që ka dijëni dhe ka sqaruar si më poshtë:.....se prej rreth 10 vitesh

përdor numrin e telefonit 0695685698 të cilin e ka të rregjistruar në emrin e tij. Orgesti ka sqaruar se nëpërmjet rrejtit social Instagram është njohur me shtetasin Hermes Nikaj, ku ky i fundit publikonte video ose fotografi me me vajza të ndryshme. Më pas kanë shkëmbyer numrat e telefonit me njëri tjetrin dhe kanë komunikuar në aplikacionin “Ëhast app”. Orgesti ka sqaruar se i ka shkruar Hermesit duke i thënë nëse mund të takohet me vajzat të cilat Hermesin publikonte në foto dhe video dhe Hermesin i ka thënë se kjo gjë mund të realizohej. Orgesti sqaron se ai përzgjidhte ndonjë prej vajzave që Hermesin kishte publikuar në Instagram dhe e pyeste Hermesin po nëpërmjet mesazheve nëse mund të vinte vajza që ai kishte përzgjedhur. Hermesin i thoshte se vajzat që Orgesti kishte përzgjedhur mund të shkonte tek Orgesti vetëm nëse e respektonte me diçka. Respekti në këtë rast ishte pagesë në para ose në euro.

Orgesti sqaron se herën që ka përzgjedhur një vajzë nga ato që Hermesin kishte publikuar Instagram ka qënë para një 1 viti e disa muaj. Hermesin i ka thënë se do ja çonte vajzën aty ku ndodhej Orgesti dhe kanë rënë dakortë ta çojë tek hotel “Devi” i cili ndodhet në rrugën që shkon nga lagja “Ali Demi” për në zonën e Shkozës. Orgesti sqaron se është nisur me makinën e tij për tek hotel “Devi”, është futur brenda dhe ka marrë një dhomë. Më pas e ka kontaktuar Hermesin dhe i ka thënë ti jepje numrin e dhomës ku ndodhej. Orgesti sqaron se Hermesin ka ardhur me taksì sëbashku me vajzën që Orgesti kishte zgjedhur në Instagram, janë ngjitur lart në dhomë sëbashku me vajzën pasi janë prezantuar, Orgesti sqaron se ai e ka pëlqyer vajzën dhe paradhënie i ka bërë pagesën Hermesit e cila ka qënë 5000 lek të reja. Gjatë kësaj kohe Hermesin ka qëndruar në dhomë sëbashku me Orgestin dhe me vajzën. Orgesti ndër të tjera ka sqaruar se përveç rastit që përmendi më sipër, Hermesin i ka dërguar dhe në gjashtë raste të tjera femra në hotel. Në këto raste Orgesti ka përzgjedhur vajzat në videot dhe fotografitë që Hermesin publikonte në Instagram, i ka shkruajtur atij mesazhe ku zgjidhte vajzën dhe nisej para me makinë për tek hotel “Devi”. Rezervonte dhomën dhe i dërgote me mesazh Hermesit numrin e dhomës. Orgesti sqaron se pas 30 minutash Hermesin vinte me taksì sëbashku me vajzën që Orgesti kishte përzgjedhur në publikimet e tij, i bënte pagesën paradhënie Hermesit dhe qëndronte në hotel sëbashku me vajzën. Po ashtu dhe Hermesin qëndronte në dhomën e hotelit duke u marr me telefonin e tij. Në lidhje me vajzat që Hermesin i ka dërguar Orgestit në hotel sqaron se nuk ka mundur të mësoj emrat apo të dhëna për to pasi nuk prezntoheshin, por nëse i shikon mund ti identifikoj. Në lidhje me ambientet që Orgesti ka frekuentuar me Hermesin dhe vajzat që ai i dërgonte, ka sqaruar se ka frekuentuar vetëm hotel “Devi” ku Hermesin i çonte vajzën që Orgesti përgjidhte. Pyetjes së bërë nga ana jonë se sa kohë qëndronte Orgestit në dhomën e hotelit me Hermesin dhe vajzën që i dërgonte ky i fundit, Orgesti ka sqaruar se në të gjitha rastet e sipër përmendura, koha që ai ka qëndruar në dhomë me Hermesin dhe vajzat që ai më sillte ka qënë rreth 30 – 40 minuta. Pasi Hermesin dhe vajzat futeshin në dhomën ku Orgesti ndodhej, i bënte pagesën 5000 lek ose 50 euro paradhënie Hermesit, vajzat bënin dush dhe pasi laheshin kryenin me Orgestin mardhënie seksuale, ndërsa gjatë kësaj kohe Hermesin qëndronte prezent pasi vajzat nuk ndjeheshin mirë nëse ishin vetëm.

Në këtë moment kur shtetasi Orgest Seitaj ka dhënë deklarime me vetëpërgjegjësi se ka kryer mardhënie seksuale kundrejt pagesës me vajzat që i siguronte shtetasi Hermes Nikaj, ku ky i fundit ja dërgonte në hotel. Bazuar në nenit 37 të Kodit të Procedurës Penale deklaratimet janë ndërprerë dhe është informuar se ndaj tij do të zhvillohen hetime për veprën penale të “Prostitucionit”, parashikuar nga neni 113/2 i Kodit Penal dhe se ka të drejtën e një avokati. Pas këtij momenti shtetasi Orgest Seitaj ka thënë se do të jap sqarime një moment tjetër në prani të avokatit të zgjedhur prej tij.

Në datë 02.02.2020 është pyetur si person që ka dijeni shtetasi **Endri Karafili** në lidhje me njohjen me shtetasin Hermes Nikaj si dhe komunikimet që ai ka pasur me të dhe

konkretisht të datës 22.06.2019 ku Hermes i pyet “A do të takohemi sonte” dhe Endri i thotë “Të them pak më vonë nëse i bëj bashkë ato që të thash”, Hermes i thotë “Jam gati, bëj gati 200-shen dhe takohemi dhe kënaqemi, po të pres”. Endri i është kërkuar nga ana jonë të shpjegoj me detaje për çfarë duhet të bënte gati dyqindshen dhe do të kënaqej. Në lidhje me këtë pyetje Endri ka sqaruar se përse i përket 200- shes bëhet fjalë për 200 mijë lek të vjetra të cilat Endri do ti shpenzonte me Hermesin dhe shoqet e tij për të pirë dhe dalë në darkë. Sipas tij kjo nënkupton dhe kënaqësinë duke pirë dhe dëfryer. Në deklarinimin e tij shtetasi Endri Karafili nuk jep të dhëna me interesë për hetimin.

Në datë 03.02.2020 është pyetur si person që ka dijeni shtetasia **Mela Shurdha** në lidhje me njohjen me shtetasin Hermes Nikaj si dhe komunikimet që ka pasur me të. Në deklarinimin e saj kjo shtetase ka sqaruar si më poshtë:.....ka përdorur numrat e telefonit 0676923942 dhe numrin 0692317169 por nuk e kujton saktësisht periudhën kohore që i ka përdorur. Sipas saj numrit 0676923942 duhet të jetë i regjistruar në emrin e saj ndërsa numri 0692317169 mund të jetë i rregjistruar në emrin e nënës së saj ose të saj. Në lidhje me shtetasin Hermes Nikaj, ajo sqaron se e ka njohur para 2 vitesh në një lokal në zonën e ish Bllokut. Pasi janë takuar kanë filluar të njihen më tepër dhe dilnin bashkë nëpër lokale nate, restorante dhe ambiente të ndryshme. Gjatë kohës që ka dalë me Hermesin ai ka pasur me vete dhe shoqe të tij të cilat janë disa dhe Mela nuk ja u kujtoj emrat.

Pyetjes nëse Hermes i ka prezantuar Melës ose vajzave që shoqërohej meshkuj të ndryshëm, Mela i është përgjigjur duke sqaruar se gjatë verës së vitit të kaluar i ka telefonuar Hermesin dhe i ka thënë të bëhej gati se do ta merte me makinë. Hermesin ka vajtur tek lagja e Melës me një foristradë të bardhë. Mela ka hipur në këtë makinë dhe ka vënë re se në vendin e të pasagjerit ishte i ulur Hermesin, ndërsa makinës i jepte një djalë rreth moshës 35 vjeç që quhej Adi dhe Hermesin e thërriste me emrin Adi Boli. Kanë vajtur tek hotel “Vivi la Vita” që ndodhet në zonën përball liqenit të Tiranës dhe sëbashku me Adin dhe Hermesin, janë futur në një dhomë të hotelit. Ajo sqaron se pasi kanë konsumuar alkool Hermesin dhe Adi kanë filluar të prekeshin në vendet intime dhe kanë kryer marrëdhënie seksuale me njëri – tjetrin. Gjatë kësaj kohe Mela sqaron se ka qëndruar në dhomë e pranishme dhe nuk ka kryer marrëdhënie seksuale me Hermesin dhe Adin. Sipas saj prezenca e Melës në dhomën e hotelit ka qënë pasi Hermesin dhe Adi të mos të binin në sy që kryenin marrëdhënie seksuale me njëri - tjetrin por të dukej sikur dhe Mela ishte pjesë e kësaj marrëdhënie.

Nga ana jonë është pyetur shtetasia Mela Shurdha në lidhje me komunikimet e datës datë 01.08.2019 ku shtetasi Hermes Nikaj ka komunikuar nga numri i tij i telefonit me numrin 0692317169 ku ndër të tjera zhvillohet një bisedë ku bashkëbiseduesja i thotë Hermesit “*Me kë je, e njoh unë atë çunin*” dhe Hermesin ju përgjigjet duke ju thënë “*Hajde se jam unë*”, “*Hajde se jam me një makinë të bardhë të madhe*”. Në lidhje me këtë rast Mela ka sqaruar se Hermesin ka qënë në makinë i shoqëruar me personin me emrin “Adi Boli” dhe është rasti kur kanë vajtur tek hotel “Vivi La Vita”, ku Hermesin ka kryer marrëdhënie seksuale me Adi Bolin. Mela sqaron se hera e dytë që ajo është takuar me Hermesin dhe Adin ka qënë kur kanë vajtur përsëri tek hotel “Vivi La Vita” ku janë futur të tre në dhomën e hotelit dhe pasi kanë konsumuar alkool Adi i ka kërkuar Melës të kryente marrëdhënie seksuale me të, por Mela sqaron se nuk ka pranuar. Kjo gjë ka bërë që Adi të mërzitej dhe ti mbetej qejfi me Hermesin. Ai ka njoftuar një taksist ku paratë për të i ka paguar Adi dhe janë larguar. Mela sqaron se Hermesin nuk i ka treguar nëse Adi donte të kryente marrëdhënie seksuale me Melën, por i ka thënë që të shkojnë e ti marrim ndonjë lek. Mela sqaron se Hermesin kur pa që Mela nuk isha dakort për të shkuar me Adin i tha atij që e lëmë herë tjetër dhe kjo shërbeu si qefëmbetje për Adin. Mela sqaron se nuk e ka takuar më Adin me Hermesin pas atij momentin dhe nuk ka informacion nëse Hermesin i kishte dërguar vajza të tjera Adit. Pasi kanë shkëmbyer numrat e telefonit me Adin, Mela sqaron se ai i ka telefonuar dhe janë



takuar vetëm për vetëm me të dhe 3 herë të tjera ku një herë Adi i ka dhënë para për qejf Melës dhe i ka thënë se mund të shkonte tek dyqani i tij të shikoja për rroba. Mela sqaron se ka qëndruar dhe njëherë vetëm me Adin në hotel “Vivi La vita”.

Në datë 03.02.2020 është pyetur si person që ka dijeni shtetasia **Dajana Shabani (Deda)** në lidhje me njohjen me shtetasin Hermes Nikaj si dhe komunikimet që ajo ka pasur me këtë shtetas dhe konkretisht ato të datës 30.06.2019 ku Dajana i kërkon shtetasit Hermes Nikaj të shkojë dhe të votojë dhe se i duhet shenja e tij e votimit. Në lidhje me këtë komunikim Dajana ka sqaruar se ajo ka pasur dëshirë që Hermesit të merte pjesë në zgjedhje. Sipas saj duke ditur që Hermesit nuk e mban fjalë i ka kërkuar ti niste me foto shenjën gishtit që kishte votuar. Në lidhje me momentin kur Dajana i thotë Hermesit se do ti jap 20 mijë lek që ai të votoj dhe përse duhet që ajo ta nxis Hermesin të votoj duke i premtuar pagesë, Dajana ka sqaruar se ajo ka pasur thjeshtë dëshirë personale që Hermesit të merte pjesë në votime dhe asgjë më shumë.

Po në këtë bisedë Dajana i thotë Hermesit të marrë dhe grupin e gatshëm dhe të votoj. Nga ana jonë i është kërkuar Dajanës të shpjegojë se çfarë ka dashur të thotë me fjalën grupi i gatshëm. Në lidhje me këtë pyetje Dajana ka sqaruar se Hermesit e përshkruante shoqërinë e tij që përbëhej nga një grup personash dhe nisur nga kjo ajo i ka kërkuar Hermesit të marrë dhe këtë grup personave duke i identifikuar si grupi i gatshëm dhe sipas saj e gjitha ka qënë në formën e një batute. Po në këtë bisedë Dajana i ka kërkuar Hermesit të marrë ndonjë shoqe, nënën e tij dhe Hermesit i kërkon të bëni gati njëzetëshen dhe Dajana vijon ti thonë se do ja bëjë gati dhe se t’ju a dërgoj me “ashu” dhe mos ta gënjej. Në lidhje me këtë komunikim shtetasia Dajana Shabani është pyetur nga ana jonë nëse ka dijeni që shtetasi Hermes Nikaj ka votuar, po ashtu nëna e tij apo personat e tjerë që ajo i identifikon si grupi i gatshëm. Kësaj pyetje Dajana i është përgjigjur duke sqaruar se nuk është në dijeni nëse Hermesit ka marrë pjesë në votime gjithashtu nuk ka dijeni nëse kanë votuar dhe nëna e tij apo rrethi i tij shoqëror. Në vijim të komunikimeve që shtetasia Dajana Shabani ka me Hermes Nikaj është pyetur nga ana jonë dhe për momentin ku ajo i thotë Hermesit të shkojë dhe të votojë pasi del nëse ai nuk ka votuar dhe i betoheni për vajzën e saj për këtë gjë. Në lidhje me këtë moment Dajana ka sqaruar se nuk i kujtohet ky moment por sipas saj e gjithë biseda që ka bërë me Hermesin për ditën e votimit ka qënë për shaka dhe se nuk e ka takuar Hermesin pas ditës së votimit dhe nuk i ka bërë asnjë lloj pagese në lidhje me pjesëmarrjen e tij në zgjedhje.

Në datë 04.02.2020 është pyetur si person që ka dijeni shtetasia **Senëra Hoxha** në lidhje me njohjen me shtetasin Hermes Nikaj si dhe komunikimet që ajo ka pasur me këtë shtetas. Në deklarinë e saj shtetasia Senëra Hoxha nuk jep të dhëna me interesë për hetimin.

Nisur nga të dhënat që kanë rezultuar gjatë hetimit të këtij procedimi penal dhe konkretisht raporteve të vëzhgimit dhe procesverbaleve të transkriptimit, në datë 03.03.2020 shoqëruar për në ambientet e D.V.P. Tiranë shtetasia **Blerta Duka**, e cila është pyetur si person që ka dijeni i në lidhje me njohjet që ajo ka me shtetasit Hermes Nikaj dhe Anjeza Bena, komunikimet që ajo ka pasur me këta persona, vendet që ka frekuentuar etj.

Blerta sqaron se aktualisht përdor numrin e telefonit 0693474866, ndërsa vitin e kaluar ka përdorur numrin e telefonit 0698890548 i cili ka qënë i regjistruar në emrin e saj.

Në lidhje me shtetasin Hermes Nikaj ose ndryshe Zogun e Tiranës, Blerta ka sqaruar se e ka njohur 3 vite më parë në sallonin e shtetasës Anjeza Bena që ndodhet në rrugën “Myslym Shyri” pranë karburantit “Kastratit”. Më pas janë bërë miq në rrjetet sociale dhe kanë dalë disa herë për kafe, si dhe kanë frekuentuar ambiente të ndryshme përgjithësisht lokale nate, “Artist” apo klubet e strip. Në lidhje me shtetasen Anjeza Bena, Blerta sqaron se e njeh prej shumë vitesh pasi banojnë në të njëjtën lagje. Blerta Unë ka vajtur në parukerinë e Anjezës

për të marrë trajtime estetike dhe për të blerë produktet që ajo shet. Blerta sqaron se para 2 vitesh Anjeza i ka ofruar të punonin sëbashku ku Blerta të shiste produkte si, kremra trupit, fytyrës etj. Blerta ka filluar punë ku merte produktet prej Anjezës dhe i shiste tek rrethi saj shoqëror ose tek të njohurit. Në bazë të shitjeve të produkteve merte një përqindje nga Anjeza e cila ishte sipas marveshjes që kishin bërë me njëra – tjetrën.

Në lidhje me lëvizjet e datës 24.06.2019 ku shtetasia Blerta Duka është konstatuar në shoqërinë e shtetasit Hermes Nikaj, ku sëbashku me të ka hipur në rrugën e “Durrësit” në një automjet Mazda me ngjyrë të kuqe me targa amerikane dhe kanë vajtur në zonën e ish parkut në rrugën “Ndre Mjeda”, ku drejtuesi i mjetit ka shkëmbuer diçka me një person dhe më pas janë larguar në drejtim të Saukut, Blerta sqaron se ky rast bën fjalë për një shokun e saj nga Vlora i cili quhet Aldo Piperi. Sipas saj Aldo kishte ardhur në Tiranë dhe pasi janë takuar, kanë shëtitur me makinë sëbashku me Hermesin. Pasi kanë vajtur tek ish parku aty Aldo ka marrë nga një person që Blerta nuk e njeh një qese lëndë narkotike hashash të cilën e ka paguar 500 lek. Më pas të tre sëbashku kanë vajtur në Sauk ku aty ka vajtur më pas dhe shoku i Hermesit, shtetasi Franci Popoci. Të katërt sëbashku kanë vajtur tek një vend sipër Saukut dhe kanë konsumuar të gjithë sasinë e ashashit që kishin blerë. Më pas janë kthyer në Tiranë ku Aldo ka ikur, ndërsa Blerta dhe Hermesin kanë dalë për të pirë me Hermesin. Në këtë datë Blerta sqaron se ka bisedaur me telefonin e Hermesit me Aldon i cili ndodhej në hotel dhe këkonte të pinte ashash. Ai i ka kërkuar Blertës të shkonte në hotel tek ai, por Blerta sqaron se nuk ka vajtur. Më pas kanë vajtur tek lokal “Artisit” në rrugën “Don Bosko”. Hermesin i ka thënë Blertës se do të vinin dy djem dhe do të dilnin me ta. Blerta sqaron se ka menduar se do të dilnin thjesht për ndonjë xhiro dhe për të pirë diçka. Pasi disa minutash Blerta dhe Hermesin kanë dolë nga lokali dhe kanë hipur në një makinë me ngjyrë gri në të cilën ishin 2 djem. Njëri nga djemt Blerta e identifikon si recepsionistin e hotel “Vivi La Vita” i cili quhet Miljan. Pasi kanë shëtitur sëbashku, kanë ndaluar prapa karburant “Kastratit” në afërsi të pallatit me shigjeta. Më pas kanë hipur përsëri në makinë. Blerta sqaron se gjatë kësaj kohe djemtë i kanë thënë Hermesit që të shkonim me ta në ndonjë hotel. Blerta i ka bërë shenjë Hermesit që mos të shkonim pasi nuk i pëlqente kjo gjë dhe ju ka thënë djemve që nuk donte të shkonin në hotel, por Hermesin i ka thënë Blertës që do të iknin dhe ashtu kanë bërë. Blerta sqaron se kanë vajtur tek hotel “Mers”, ku djemtë kanë marrë një dhomë, ku kanë qëndruar të katërt. Blerta sqaron se Hermesin i bëri seks oral djalin të cilin Blerta nuk ja di emrin, ndërsa Miljani e ka ngacmuar Blertën dhe i ka kërkuar të shkonte me të, por Blerta nuk ka pranuar dhe nuk ka kryer mardhënie seksuale me asnjë person. Sipa saj i vetmi që ka kryer seks oral ka qënë Hermesin. Në lidhje me këtë rast Blerta sqaron se asaj nuk i është bërë asnjë pagesë dhe nuk ka vënë re që ti bëhej pagesë Hermesit prej djemve. Pasi kanë dalë nga hoteli i ka ndaluar policia dhe i ka verifikuar. Ndër të tjera Blerta ka sqaruar se gjatë kohës që ka qëndruar me Hermesin, ai i ka treguar se njihte persona të ndryshëm të cilët kishin para dhe paguanin në këmbim të mardhënieve seksuale. Hermesin i ka shpjeguar asaj se ai kishte kohë që ju siguronte këtyre personave femra të ndryshme për të kryer seks kundrejt pagesës. Ajo sqaron se pas kësaj bisede Hermesin filloi ti sillte situatat e atilla të cilat dukeshin si rastësore por përfundojë në hotel me persona që Hermesin i njihte dhe paguhej prej tyre. Blerta sqaron se Hermesin filloi të ishte i drejtëpërdrejtë me Blertën ku i thoshte se do të dilnin sëbashku me shokë të tij dhe më pas do të shkonim në hotel dhe do të kryenin mardhënie seksuale me ta kundrejt pagesës. Sipas Blertës pagesa që personat do të bënin në këmbim të mardhënieve seksuale me Blertën ishte mbi 100 deri 150 euro dhe kjo pagesë do të ndahej mes Hermesit dhe Blertës. Blerta sqaron se për rastet që pagesa ishte 100 euro do të ndahej gjysëm përgjysëm me Hermesin, ndërsa kur ishte 150 euro Hermesin do të merte 50 euron. Për rastet që Hermesin do të kryente vetë mardhënie seksuale me klientët pagesa do të ishte e tij. Blerta ka sqaruar se ka kryer mardhënie seksuale kundrejt pagesës me klientët që i ka siguruar Hermesin dhe për këto raste

Hermesi ka marrë pjesën e tij të pagesës.

Në këtë moment kur shtetasia Blerta Duka ka dhënë deklarime me vetëpërgjegjësi ku sqaron se ka kryer mardhënie seksuale kundrejt pagesës me klientët që i siguronte shtetasia Hermes Nikaj, bazuar në nenin 37 të Kodit të Procedurës Penale deklarimet janë ndërprerë dhe shetetasia Blerta Duka është informuar se ndaj saj do të zhvillohen hetime për veprën penale të "Prostitucionit", parashikuar nga neni 113/1 i Kodit Penal dhe se ka të drejtën e një avokati. Është njohur me listën e të drejtave të personit nën hetim dhe në prani të avokatit të caktuar kryesisht Z.Armir Veizi, ajo ka sqaruar se mbi pesë herë Hermesi i ka siguruar asaj klient për prostitucion. Blerta ka sqaruar se Hermesi i bënte vetë bisedat me klientët pa praninë e Blertës. Në disa raste komunikonte me ta nëpërmjet telefonit, takohej me ta ose i gjente në lokalet e natës. Pasi kishte bërë bisedat me klientët Blerta sqaron se Hermesi i thoshte asaj që do të shkonim në hotel me një mikun e tij. Në disa raste e thoshte në mënyrë të drejtëpërdrejtë që Blerta do të shkonte të kryente mardhënie seksuale kundrejt pagesës me personin e siguruar prej Hermesit, ose në raste të tjera e linte të nënkuptohej që Blerta duhet të bënte diçka të tillë. Kjo ishte në varësi të situatës ose ambientit ku ndodheshin.

Blerta sqaron se me Hermesin ka vajtur në disa hotele në qytetin e Tiranës ku e prisnin klientët ose personat që Hermesi i njihte. Sipas saj në një rast e ka marrë Hermesi dhe kanë vajtur me taksì tek hotel "Autostrada" që ndodhet në rrugën dytësore pasi kalon QTU-në. Hermesi i ka thënë se në hotel po e priste një mik i tij i cili quhej Turi dhe ishte pronari i një servisi BMW-je në zonën e Laçit të cilin Hermesi e kishte të shënuar në celular me emrin TurX5-sa. Personi me emrin Turi po priste në dhomën e hotelit. Blerta sqaron se pasi ka hyrë unë në dhomë sëbashku me Hermesin kanë marrë diçka për të pirë dhe Hermesi i ka kërkuar Turit paradhënie pagesën për Blertën. Turi i ka dhënë në prani të Blertës 150 euro Hermesit dhe aty Blerta ka kryer mardhënie seksuale me Turin. Gjatë kësaj kohe Hermesi ka qëndruar në dhomë dhe pasi Blerta ka përfunduar, Hermesi ka marrë një taksì dhe janë larguar. Blerta sqaron se për këtë rast Hermesi ka mbajtur një pjesë të eurove që ka marrë prej Turit.

Në një rast tjetër Blerta sqaron se i ka marrë me një fuoristradë të bardhë Mercedes Benz ML një person të cilin Hermesi e thëriste me emrin Adi Boli. Pasi kanë hipur në makinën e Adit, kanë vajtur në një hotel në zonën e Kombinatit emrin e të cilit Blerta nuk e kujton dhe janë futur në dhomë Blerta, Hermesi dhe Adi. Pasi kanë konumuar nga një pije Hermesi i ka kërkuar paradhënie pagesën Adit. Sipas saj Adi i ka dhënë Hermesit 150 euro, dhe Blerta sqaron se ka kryer mardhënie seksuale me Adin. Gjatë kohës që Blerta ka kryer mardhënie seksuale me Adin, Hermesi është përfshirë në këtë mardhënie ku ka kryer me Adin seks oral. Pasi kanë përfundur Adi i ka kthyer në Tiranë dhe janë ndarë. Blerta sqaron se edhe në këtë rast paratë janë ndarë mes saj dhe Hermesit. Blerta tregon në lidhje dhe me një rast tjetër që kanë qënë në ambientet e hotel "Vivi La Vita" po me personin që ajo identifikon me emrin Adi Bol. Sipas saj kanë vajtur në hotel Blerta, Adi dhe Hermesi. Ajo sqaron se Hermesi ka marrë pagesën paradhënie prej Adit, por Adi nuk ka kryer mardhënie seksuale me Blertën, por ka kryer mardhënie seksuale vetëm me Hermesin. Në këtë rast Blerta nuk ka marrë pagesë pasi është përfshirë në mardhënien seksuale.

Blerta sqaron se një rast tjetër ka qënë po me Adi Bolin dhe një shokun e tij, Hermesin dhe një shoqen e Hermesit e cila punonte në polici dhe quhej Dejnida Balliu. Kanë vajtur me makinën e Dejnidës e cila është Merdec Benz A – clas tek hotel "Star" ku Adi Boli dhe shoku i tij kishin marrë 2 dhoma. Blerta sqaron se Hermesi i ka thënë Dejnidës që të shkonte tek dhoma ku ndodhej shoku i Adit për të kryer me të mardhënie seksuale dhe Dejnida ashtu ka bërë, ndërsa Blerta dhe Hermesi janë futur në dhomën ku ndodhej Adi dhe kanë qëndruam duke pritur sa të mbaronte Dejnida me shokun e Adit. Gjatë kohës që Blerta, Hermesi dhe Adi qëndruam në dhomë nuk kanë kryer mardhënie seksuale por vetëm kanë konsumuar alkool. Adi i ka bërë pagesën Hermesit prej 100 eurosh për Dejnidën që shkoi me shokun

e tij. Blerta sqaron se pasi Dejnida përfundoi, erdhi tek dhoma që ndodhej Hermesi, Blerta dhe Adi.

Blerta sqaron se Adi i ka kërkuar asaj të shkonte dhe të kryente mardhënie me shokun e tij, por Blerta nuk ka pranuar pasi nuk i ka pëlqyer kjo gjë. Adi i ka ofruar 100 euro të cilat Blerta sqaron se i ka marrë edhe pse nuk pranoi të shkonte me shokun e tij. Sipas Blertës kur Dejnida pa që Blerta ka marrë lekët pa kryer mardhënie seksuale, është mërzhitur se përse Blerta mori lek pa kryer seks, pasi ishte Dejnida ajo që kishte kryer seks dhe do duhet ti ndante paratë me Hermesin. Blerta sqaron se ajo, Hermesi dhe Dejnida u larguan dhe gjatë rrugës Hermesi i mori Dejnidës pjesën e tij të parave.

Blerta sqaron se në një tjetër rast Hermesi i ka thënë asaj, Dejnidës dhe Alba Fraholli se do të shkonim tek hoteli “Lubjana” që ndodhet ngjitur me lokal “Zio Nino”, pasi aty i priste pronari i Zio Ninos që quhej Avni sëbashku me një shokun e tij. Kanë vajtur në hotel Blerta, Hermesi, Dejnida dhe Alba dhe janë futur në një dhomë ku ndodhej Avniu me shokun e tij. Kanë pirë të gjithë në një dhomë alkool dhe sipas Blertës Dejnida ka vajtur me shokun e Avniut në një dhomë tjetër ku kanë kryer mardhënie seksuale, ndërsa Blerta, Alba, Avniu dhe Hermesi kanë qëndruar në dhomë duke pirë alkool. Blerta sqaron se në këtë rast unë, Hermesi apo Alba nuk kemi kryer mardhënie seksuale me askënd. Ajo sqaron se nuk e di se si e kanë paguar Dejnidën për këtë rast pasi gjithë bisedat i bënte Hermesi për pagesën.

Blerta ka sqaruar se Turin, Adi Bolin dhe Avniun i kanë takuar disa herë në hotele në rrethana të njëjta me ato që përmenden mësipër. Gajtë bisedave të zhvilluara mes Blertës, Hermesit dhe Dejnidës, ajo ka mësuar Hermesi e kishte dërguar Dejnidën në hotel për të kryer mardhënie seksuale kundrejt pagesës me Avniun, pronarin e “Zio Ninos”

Blerta ka sqarur se Hermesi kishte në lidhje për këtë aktivitet dhe një vajzë me emrin Denisa, një vajzë tjetër me emrin Mela, për të cilat ka dëgjuar vetëm biseda dhe nuk ka parë asgjë konkrete.

Në lidhje me daljen nga Republika e Shqipërisi në datë 28.09.2019 ora 15:32’ nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Kakavije dhe hyres po nëpërmjet kësaj pike kalimi në datë 29.09.2019 ora 20:44’, shtetasia Blerta Duka sqaron se në vitin 2017 Anjeza Bena i ka thënë Blertas nëse kishte dëshirë të shkote me Anjezën në Greqi dhe disa miq të saj për tu argëtuar në buzuk në qytetin e Pargës.

Sipas saj Anjeza i ka kërkuar Blertës të merte ndonjë shoqe me vete pasi do të kënaqeshin. Në këto kushte Blerta sqaron se ka pranuar të shkoja me Anjezën duke qënë se dhe punote tek biznesi i saj. Anjeza ka biseduar me mamanë e Blertës, Mirelën të cilës i ka marrë leje për Blertën. Anjeza i ka shpjeguar Blertës se në këtë udhëtim do të ishte Anjeza, i dashuri i saj të cilin e thëriste në disa raste me emrin Xhixho ose Gramos dhe disa shok të Gramosit. Blerta sqaron se Xhixho dhe Gramosi ishin i njëjti person. Blerta ka biseduar me shoqen e saj Paola Agastra të cilës i ka thënë nëse dëshironte mund të shkonte me Blertën. Pasi Paola ka rënë dakort duke qënë se e njihte dhe ajo Anjezën prej Blertës, ditën e nesërme Blerta dhe Paola janë takuar me Anjezën dhe me makinë e kësaj fundit kanë udhëtuar në drejtim të qytetit të Fierit. Në Fier janë takuar me Gramosin i cili ishte i vetëm. Më pas na ju është bashkuar dhe një shoku i Gramosit të cilin e thërinin me emrin Çesku dhe kanë udhëtuar të gjithë sëbashku nga Fieri në drejtim të Kakavijes. Blerta sqaron se pasi kanë kaluar në tokën greke kanë udhëtuar në drejtim të qytetit të Pargës. Kanë vajtur në një hotel emrin e të cilit nuk e kujton dhe kanë zënë dhomat. Sipas Blertës në Pargë ndodheshin dhe disa miq të Gramosit emrat e të cilëve nuk i kujton. Kanë shëtitur në qytet dhe pasi kemi darkuar jemi kthyer në hotel. Blerta sqaron se ka qënë në dhomë me Paulën, ndërsa Anjeza ka qëndruar me Gramosin dhe Çesku kishte një dhomë më vete. Blerta sqaron se gjatë kohës që kanë qënë në hotel Anjeza i thotë Blertës dhe Paulës në të njëjtën kohë që Çesku donte të kalonte natën

me një rën prej ne të dyjave kundrejt pagesës. Blerta sqaron se në kushtet që ndodheshin pranuar që njëra prej tyre të shkonte dhe të kryente marrëdhënie seksuale me Çeskun. Blerta sqaron se ajo dhe Paola kanë vajtur në dhomën e Çeskut dhe Paola ka kryer marrëdhënie seksuale me Çeskun, ndërsa Blerta i ka ofruar Çeskut vetëm seks oral. Më pas Blerta sqaron se është larguar, ndërsa Paola ka kaluar natën me Çeskun. Sipas Blertës për atë që kanë bërë me Çeskun, ky i fundit i ka paguar në euro, por nuk e kujton saktësisht se sa.

Blerta sqaron se Anjezës ju bë qejfi që Blerta dhe Paola kishin bërë Çeskun të ndjehej mirë. Sipas saj ditën e nesërme janë kthyer për në Shqipëri të gjithë sëbashku me Anjezën, Paolën, Çeskun dhe Gramozin dhe në Fier kanë marrë makinën e Anjezës dhe kanë ardhur në Tiranë. Për sa i përket datës 28.09.2019 Blerta sqaron se Anjeza e ka telefonuar dhe i ka kërkuar të shkoj përsëri me të në Greqi ku do të ishte me Gramosin, Çeskun dhe një shoqen e saj. Nga mënyra se si u zhvillua biseda Anjeza i ka lënë Blertës të kuptoj se Blerta do të bënte të njëjtën gjë siç kishte bërë dhe herën e mëparshme në Greqi. Blerta sqaron se duke qënë se ishte në gjendje jo të mirë financiare, ka pranuar të shkoj me Anjezën dhe miqt e saj. Ditën e nesërme pas kësaj bisede, është takuar me Anjezën e cila ishte sëbashku një shoqen e saj dhe kanë udhëtuar me makinën Anjezës nga Tirana në Fier. Në Fier Blerta, Anjeza dhe shoqja e saj janë takuar me Gramosin dhe Çeskun dhe kanë udhëtuar me makinën e Çeskut të gjithë sëbashku në drejtim të Kakavijes. Pasi kanë kaluar në shtetin grek kanë udhëtuar në drejtim të Pargës. Pasi kanë mbëritur në Pargë kanë vajtur në një hotel ku kishin rezervuar tre dhoma. Gjatë kohës që po qëndronin të gjithë sëbashku, Blerta sqaron se Çesku ikën në dhomë e tij. Pas këtij momenti Anjeza shkon tek Blerta dhe i kërkon asaj të shkoj në dhomën e Çeskut. Blerta sqaron se është larguar nga ambienti ku po qëndronte me Gramosin, Anjezën dhe shoqen e Anjezës dhe ka vajtur në dhomën e Çeskut.

Blerta sqaron se në dhomë Çesku po e priste i zhveshur dhe i kërkoi të shtrihej me të ku kryen marrëdhënie seksuale. Pasi kanë mbaruar Blerta sqaron se ka dalë nga dhoma dhe ju është bashkuar Anjezës, Gramosit dhe shoqes së Anjezës. Më pas Blerta sqaron se ka vajtur për të fjetur. Blerta sqaron se ditën e nesërme Çesku i ka dhënë 300 euro për marrëdhëniet seksuale që kisha kryer me të. Anjeza e ka pyetur Blertën se sa para më kishte dhënë Çesku dhe Blerta i ka treguar Anjezës në lidhje me pagesën e marë. Pasi kanë shëtitur në Pargë të gjithë sëbashku janë kthyer në Shqipëri, ku Çesku dhe Gramosi kanë qëndruan në Fier ndërsa Blerta, Anjeza dhe shoqja e saj kanë ardhur në Tiranë.

Blerta sqaron se Anjeza i kishte thënë se kushdo që do të kalonte natën me Çeskun do të paguhej. Sipas saj nuk kishin biseduar për vlerën por sqaron se marrëdhëniet seksuale do të kishte pagesë. Nuk di të them nëse Anjeza është paguar për këtë gjë sipas Blertës sihte Anjeza ajo që ju siguronte vajza për të kryer marrëdhënie seksuale shokëve të Gramozit, si në rastin e saj.

Pyetjes nëse Blerta është ndjerë nën presion për të kryer veprime të tjera, ajo i është përgjigjur duke sqaruar se Anjeza e sillte bisedën dhe situatën si diçka që ndodhte për qejf, panvarsisht se për Blertën kjo ska qënë aspak argëtuese pasi për shak të gjendjes ekonomike është detyruar të përgjigjem ftesave të Anjezës ku më pas përfundonte duke kryer marrëdhënie seksuale. Blerta sqaron se pas këtyre rasteve Anjeza i ka shkruar dhe i ka kërkuar të takohen me të gjë që nënkuptonte se i kishte gjetur persona për të kryer marrëdhënie kundrejt pagesës, por Blerta nuk i është përgjigjur kërkesave të Anjezës. Blerta sqaron se në rastet kur Blerta nuk i përgjigjej Anjezës, kjo e fundit kontaktonte Hermesin për të siguruar ndonjë vajzë me qëllim për ta dërguar për të kryer marrëdhënie seksuale kundrejt pagesës.

Shtetasia Blerta Duka është njohur nga ana jonë me të dhënat në sistemin TIMS të shtetasit Ismail Zani, i dtl. 21.04.1963 me numër identifikues G30421010S, ku nga sa ajo e njeh a e konfirmon që ky person të jetë personi me të cilin Blerta e identifikoni me emrin Çesku dhe kanë qënë sënashku me shtetasen Anjeza Bena të dashurin e saj Gramosin, Paola Agastra në Greqi në qytetin e Pargës, ku pasi u njoh me fotografinë Blerta sqaroi se personi që ju tregua

nga ana jonë në një fotografi është personi që Blerta përmend mësipër në këtë deklaram dhe e ka identifikuar me emrin Çesku.

**Të dhënat që jep shtetasia Blerta Duka në deklaramin e mësipërm në lidhje me shtetasit Hermes Nikaj dhe Anjeza Bena, lidhen me të dhënat e grumbullura nga raportet e vëzhgimit/shërbimit realizuara nga Seksioni i Operacioneve Speciale, procesverbalet e transkriptimit të bisedave të zhvilluara mes tyre, si dhe përputhen me të dhënat e sistemit TIMS i cili është kqyrur nga ana jonë për datën 12.04.2017, ku rezulton se shtetasit Anjeza Bena, Gramos Yzeiri, Blerta Duka, Ismail Zani, dhe Paola Agastra kanë dalë nga R.Shqipërisë nga pika e kalimit kufitar Kakavije, me automjetin me targë AA938HM dhe në datë 13.04.2017, po me këtë automjet këta shtetas kanë hyrë në Republikën e Shqipërisë.**

**Po në sistemin TIMS rezulton se në datë 28.09.2019 shtetasit Gramos Yzeiri, Ismail Zani, Mojlinda Shaqiri, Blerta Duka dhe Anjeza Bena, kanë dalë nga Republika e Shqipërisë nga pika e kalimit kufitar Kakavije me automjetin me targë AA681TK dhe po këta shtetas me këtë automjet kanë hyrë në Republikën e Shqipërisë nga pika e kalimit kufitar Kakavije në datë 29.09.2019. Këto të dhëna janë marrë me anë të procesverbalit të kqyrjes së sistemit TIMS.**

Nisur nga komunikimet e realizuara mes shtetasit Hermes Nikaj dhe përdoruesit të numrit të telefonit 0693078772 i cili identifikohet gjatë bisedave si “Adi Boli”, nga ana jonë janë nxjerrë një pjesë e tabulateve thirrjeve hyrëse dalëse që numëri 0693078772 (Adi Boli) ka pasur nga data 01.05.2019 deri më në datën 01.12.2019.

Nisur nga këto të dhëna ka rezultuar se numri 0693078772 Adi Boli ka thirrje hyrëse dalëse me numrin e telefonit 0682098767.

Nga përgjigja e ardhur nga kompania telefonike Vodafone Sh.A. numri i telefonit 0693078772 figuron i regjistruar në emër të shtetases Egla Vokri, lindur dhe banuese në Belaj Njësia Administrative Dajç, Shkodrës.

Në datë 15.05.2020 është pyetur përdoruesja e numrint të telefonit 0682098767 shtetasia **Suada Mane** e cila ka sqaruar se;..... nuk njeh asnjë person me emrin Egla Vokri. Në lidhje me komunikimet që kjo shtetase ka nga numri i saj 0682098767 me numrin 0693078772 (Adi Boli), për periudhën Maj – Nëntor të vitit 2019, Suada sqaron se numrin 0693078772 e ka të shënuar në aparatën e saj celular me emrin “NYE”. Ajo sqaron se ka qënë data 30.12.2018 kur ka qënë duke darkuar me shoqen e saj Elda Koçi tek zgara “Dragon” që ndodhet tek Komuna e Parisit kur tek tavolina e tyre është afuar pronari i restorantit i cili quhej Adriatik dhe shkurt e thërisnin Tiku, i cili njihej me Eldën. Suada ka sqarur se gjatë darkës ka shkëmbyer numrin e saj të telefonit me Tikun, ku numri që Tiku i ka dhënë ishte numri 0693078772. Suada sqaron se ka komunikuar disa herë me këtë person dhe ka dalë një herë me të për një gotë. Suada nuk jep të dhëna të tjera në lidhje me këtë person.

Është bërë kqyrja e e faqes zyrtare të Q.K.B. në datë 28.07.2020 për marrjen e të dhënave për subjektin tregëtar që jep në deklaramin e saj shtetasia Suada Mane që ndodhet në Komunën e Parisit.

Në datë 20.05.2020 është pyetur si person që ka dijeni për ngjarjen shtetasia **Egla Vokri** e cila ka sqaruar se;.... numri 0693078772 nuk i kujton asgjë dhe nuk është përdorur asnjëherë prej saj për shkak se në zonën ku ajo banon nuk ka valë të mjaftueshme të kompanisë celulare Vodafone dhe për këtë arsye përgjithësisht përdoren numra të kompanisë Eagle që fillojnë me

“067”. Egla ka sqarur se nuk njeh asnjë person me emrin Adriatik, Tiku, apo Adi. Në lidhje me regjistrimin e këtij numri celular në datë 21.05.2019 me emrin Egla Vokri në qytetin e Shkodrës, Egla sqaron se nuk është ajo që e ka bërë këtë regjistrim e këtij numri telefoni në emrin e saj dhe nuk ka autorizuar asnjë njeri të bëjë një veprim të tillë. Sipas saj ajo nuk ka asnjë informacion se si ka nodhur një gjë e tillë.

Nisur nga të dhënat e nxjerra nga tabulatet e numrit 0693078772 (Adi Boli) thirrjeve hyrëse - dalëse për periudhën 01.05.2019 deri më në datë 01.12.2019, është pyetur shtetasi **Ardet Muçobega**, në datë 14.05.2020, i cili ka sqarur se përdor numrin 0695131559 prej kohësh. Ardeti ka sqaruar se ka përdorur disa automjete mes të cilave dhe automjetin e markës Mercedes Benz ML me ngjyrë të bardhë, me targë AA500OP, i cili është në pronësi shtetasit Aimir Skënderaj i cili është kushuri i babait të tij. Ndër të tjera Ardeti ka sqarur se vitin e kaluar ka frekuentuar hotel “Star” pranë Liqenit të Thatë, një hotel në rrugën e Elbasanit dhe hotel “Vivi La Vita” ku ka qënë me bashkëshorten e tij. Në lidhje me komunikimet që shtetasi Ardet Muçobega ka nga numri i tij me numrin 0693078772, në datë 28.05.2019 ora 22:29’ ky shtetas sqaron se këtë numër nuk e mban mend, nuk di se përse ka komunikuar dhe përse e ka bërë këtë bisedë.

Në datë 04.05.2020 është pyetur si person që ka dijeni shtetasja **Alketa Brauhshaj** në lidhje me njohjen me shtetasin Hermes Nikaj si dhe komunikimet që ajo ka pasur me të, ku në deklarinimin e saj shtetasja Alketa Brauhshaj nuk jep të dhëna me interesë për hetimin.

Në datë 14.05.2020 është pyetur si person që ka dijeni shtetasia **Livia Tabaku** në lidhje me numrin e telefonit 0693840004 të rregjistruar në emrin e saj në datë 28.07.2018. Në deklarinimin e tij shtetasja Livia Tabaku nuk jep të dhëna me interesë për hetimin.

Në datë 15.05.2020, pasi është njohur me letrën e të drejtave, në prai të avoketes së zgjedhur prej tij është pyetur si person nën hetim shtetasi **Armando Nushi**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Prostitucioni”, parashikuar nga neni 113/2 i Kodit penal, pasi në datë 09.11.2019 është kapur në flagrancë sëbashku me shtetasen Ana Sula. Në deklarinimin e tij ky shtetas sqaron se shtetasen Ana Sula e ka sjellë mikesha e tij Anjeza Bena në ambientin ku Armando po darkonte, të cilën Anjeza e ka prezantuar si shoqen e saj. Në lidhje me shtetasen Ana Sula, Armando sqaron se ishte hera e parë që po e shikonte. Në deklarinimin e tij shtetasi Armando Nushi nuk jep të dhëna me interesë për hetimin.

Në datë 18.05.2020 është pyetur si person që ka dijeni shtetasi **Arsen Mete** në lidhje me numrin e telefonit 0699884422 i cili figuron i regjistruar në emrin e tij. Në lidhje me këtë numër ky shtetas sqaron se ja ka kërkuar një person të cilin e identifikon me emrin Fatjon, por e thërrasin dhe me emrin Fotaq i cili banon në lagjen “1 Maji” në qytetin e Fierit. Arseni sqaron se nuk e ka idenë se çfarë ka bërë Fatjoni me numrin e telefonit 0699884422, por thekson se ja ka dhënë me mirbesim. Në lidhje me Fatjonin ose njohur ndryshe me emrin Fotaq, Arseni sqaron se është rreth moshës 30 – 35 vjeç dhe është nipi i një personi që e njohin në qytetin e Fierit me emrin Xhixho.

Në datë 19.05.2020 është pyetur si person që ka dijeni shtetasia **Rajmonda Kaja** në lidhje me numrin e telefonit 0699375451 i cili figuron i regjistruar në emrin e saj. Në lidhje me këtë numër kjo shtetase sqaron se ja ka dhënë një të afërme të bashkëshortit të saj që quhet Enxhi (Kaja) Kokoneshi. Në deklarinimin e tij shtetasja Rajmonda Kaja nuk jep të dhëna të tejshtetë me interesë për hetimin.

Në datë 20.05.2020 është pyetur si person që ka dijëni shtetasia **Ledja Hamzi** në lidhje me komunikimet që kjo shtetase ka nga numri i saj i telefonit 0696472960 me shtetasen Floresha Sula. Ledja sqaron se;... nga bashkjetesa me djalin e shtetases Floresha Sula, i cili quhet Sajmir Sula ka një vajzë të mitur. Në lidhje me aktivitetit e shtetases Floresha Sula, Ledja sqaron se Floresha meret me hedhje falli. Sipas saj Floresha qëndronte në një lokal pranë Stacionit të Trenit, ambient i cili frekuentohej nga prostituta. Në deklarin e tij shtetasja Ledja Hamzi nuk jep të dhëna me interesë për hetimin.

Në datë 20.05.2020 është pyetur si person që ka dijëni shtetasia **Enxhi Kaja (Kokoneshi)** në lidhje me komunikimet që kjo shtetase ka nga numri i telefonit 0699375451 me shtetasen Floresha Sula dhe konkretisht komunikimin e datës 20.10.2019. Në deklarin e tij shtetasja **Enxhi Kaja (Kokoneshi)** nuk jep të dhëna me interesë për hetimin.

Në datë 27.05.2020 është pyetur si person që ka dijëni shtetasi **Armand Beqiri** në lidhje me njohjen që ky shtetas ka me shtetasin Hermes Nikaj. Në lidhje me këtë shtetasi Armand Beqiri ka sqarur se ka disa bare në qytetin e Tiranës me emrin “Bar Artisti”. Sipas tij shtetasin Hermes Nikaj e ka njohur në ambientet e lokal “Artist”. Ai sqaron se gjatë vitit 2019 shtetasi Hermes Nikaj ka frekuentuar në mënyrë të vazhdueshme lokal “Artist” në zonën e Unazës së Re, rrugës Don Bosko, rrugës së Dibrës ku sillte në këto ambient dhe femra të moshave të ndryshme. Armandi sqaron se Hermes është paguar disa herë nga stafi i lokalit në këmbim të frekuentimit prej tij të lokal “Artist” sëbashku me vajzat që e shoqëronin atë. Në deklarin e tij shtetasi Armand Beqiri nuk jep të dhëna të tejsra me interesë për hetimin.

Në datë 29.05.2020 është pyetur si person që ka dijëni shtetasia **Anjeza Bramka** në lidhje me njohjen dhe komunikimet që kjo shtetase ka pasur me shtetasin Hermes Nikaj. Anjeza sqaron se Hermes dhe pronarja e lokal “Dr Artist” i kanë treguar se Hermes menaxhonte lokalet “Artist” në qytetin e Tiranës. Në lidhje me komunikimin e datës 22.11.2019 ku shtetasia Anjeza Bramka i dërgon mesazh me teks Hermesit “Ke nai grup femrash?” dhe Hermes i përgjigjet “Po”, Anjeza ka sqaruar se ka dashur të marr një lokal për ta menaxhuar dhe duke qënë se Hermes shoqërohej me shumë femra i kam kërkuar nëse ai mund të ishte i diponueshëm ta merja si menaxher për lokalin që do hapja ku i ka kërkuar femra që ti punësote si kamariere, banakie dhe mikpritëse ne ambiente e lokalit te cilin nuk ka arritur ta hap. Në deklarin e saj shtetasia Anjeza Bramka nuk jep të dhëna të tejsra me interesë për hetimin.

Në datë 02.06.2020 është pyetur si person që ka dijëni shtetasi **Alban (Alfred) Ruçi** në lidhje me numrin e telefonit 0692464646, numër i cili në datë 09.11.2019 i është sekuestruar sëbashku me aparatit celular shtetases Anjeza Bena. Në lidhje me këtë numër Albani ka sqarur se e ka blerë vitin e kaluar në një pikë Vodafoni në rrugën “Myslym Shyri” dhe pranë pallatit të sportit “Asllan Rusi” ja ka shitur për 3000 lek një vajze rreth moshës 30 – 35 vjeç, rreth 160 cm e gjatë, me flokë të verdha.

Në këtë moment shtetasi Alban Ruçi ka dhënë deklarime me vetëpërgjegjësi, bazuar në nenit 37 të Kodit të Procedurës Penale deklarimet janë ndërprerë dhe është informuar se ndaj tij do të zhvillohen hetime për veprën penale të “Shitja e pa autorizuar e kartave SIM”, parashikuar nga neni 293/d i Kodit Penal dhe se ka të drejtën e një avokati.

Pas këtij momenti shtetasi Alban Ruçi është njohur me letrën e të drejtave të personit nën hetim. Është pyetur si person në hetim dhe ka sqarur se do të jap sqarime një moment tjetër të hetimin në prani të avokatit të zgjedhur prej tij.



Në datë 05.06.2020 është pyetur si person që ka dijëni shtetasia **Orkida Bistri**, e cila ka sqaruar se prej datës 16.04.2015 është punonjëse e policies në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit në Gjirokastrë, në Stacionin e Policisë Kufitare Kakavije, me detyrë ndihmës specialiste kontrolli. Orkida është pyetur në lidhje me kredencialet të cilat ajo aksesohet në sistemin TIMS, ku ka sqaruar se kredencialet e saj janë “BistriO”. Ndër të tjera Orkida ka sqaruar procedurat e ndjekura nga ana e saj në datë 30.10.2019, datë kjo që përkon me veprimet e kryera prej saj në momentin që shtetasit Ana Sula, Gjergji Marini, Ismail Zani dhe Andi Papa kanë kaluar kufirin mes Shqipërisë dhe Greqisë.

Në datë 27.07.2020 është pyetur si person që ka dijëni shtetasia **Bersjana Simolla**, në lidhje me njohjen që ajo ka me shtetasin Hermes Nikaj si dhe komunikimin nga numri i saj i telefonit 0697351385 në datën 30.10.2019 me shtetasin Hermes Nikaj, ku ky i fundit i thotë “telebingo” dhe i kërkon të bëheni gati pasi do të takoni Adin me të cilin keni qënë njëherë sëbashku. Ndër të tjera Hermes i kërkon të vishet bukur siç ju keni qënë veshur herën e mëparshme. Në lidhje me këtë rast Bersjana sqaron se vitin e kaluar ka qënë e ulur me Hermesin tek lokal “Diamond” tek 21 Dhjetori. Sëbashku me ta ka qënë dhe ish i dashuri i Hermesit, Enea Dulla. Aty ka ardhur personi të cilin Hermes i ja ka prezantuar me emrin Adi i cili është ulur në tavolinë me ta. Nga biseda me të Bersjana sqaron se ka mësuar se Adi kishte disa biznese mes të cilave dhe një biznes që merr me shitjen e rrobave, fustaneve etj. Bersjana sqaron se sapo ka parë Adin i ka thënë Hermesit se Adi i pëlqeu, ndërsa Hermes i ka thënë Bersjanës se Adi ishte miku i tij dhe kishte qejf meshkujt dhe se i pëlqente Hermesit. Pas 20 minutash Adi u largua. Pas atij momenti Bersjana sqaron se e ka takuar dhe 2 herë të tjera Adin sëbashku me Hermesin. Sipas saj në një rast e ka telefonuar Hermesit dhe i ka thënë Bersjanës nëse donte të takohej me Adin dhe Bersjana ka pranuar. Ajo ka dalë tek Zogu i Zi dhe aty ka ardhur Hermesit sëbashku me Adin i cili drejtonte një foristradë me ngjyrë të bardhë. Kanë vajtur tek hotel “Iliada” që ndodhet në autostradën Tiranë – Durrës ku kanë marrë një dhomë hoteli. Pasi kanë pirë nga një pije kanë biseduar për rreth 1 orë. Bersjana sqaron se qëllimi i vajtjes saj në hotel me Hermesin dhe Adin ishte që Bersjana të shkonte me Adin, por aty ka kuptuar që Adi ishte i intereseuar për Hermesin dhe jo për Bersjanën. Në këto kushte Bersjana është larguar duke lënë në dhomën e hotelit Adin me Hermesin. Bersjana sqaron se është takuar për të fundit herë me Adin sëbashku me Hermesin në datë 30.10.2019. E ka telefonuar Hermesit i cili i ka thënë asaj “telebingo”. Sipas saj kjo ishte shprehje që Hermesit e përdorte shpesh. Ai i ka kërkuar Bersjanës të bëhej gati pasi do të takohenin Adi Bolin. Bersjana sqaron se ka rënë dakort dhe rreth orës 23:50’ ka dalë nga shtëpia dhe tek shkolla “Harri Fulz” ka ardhur Adi Boli sëbashku me Hermesin me foristradën e tij të bardhë dhe kanë vajtur tek hotel “Vivi La Vita” që ndodhet në zonën e Liqenit të thatë. Sëbashku me Adin dhe Hermesin janë futur në një dhomë dhe gjatë kohës që po konsumonim të tre një pije, Adi morri një telefonatë dhe na tha se i duhej të largohej pasi kishte një problemin e tij. Sipas saj Adi ka dalë nga dhoma, ndërsa Bersjana dhe Hermesin përfunduan pijet, thirrëm një taksì dhe janë larguar. Pas këtij momenti Bersjana sqaron se nuk e ka takuar më Adi Bolin. Në lidhje me Hermesin dhe Adi Bolin, Bersjana sqaron se ka kuptuar se ata të dy njoheshin prej kohësh me njëri - tjetrin por nuk kishin një lidhje por mes tyre. Ndodhte vetëm ajo që Bersjana shpjegon mësipër.

Në datë 28.06.2020 është pyetur si person që ka dijëni shtetasia **Johana Lluka**, në lidhje me njohjen që ka kjo shtetase me shtetasin Hermes Nikaj, sqaron se;..... e ka njohur në ambientet e restorantit e saj “Fish Store” që ndodhet në rrugën “Don Bosko”. Ai e ka frekuanetuar këtë restorant sëbashku me shtetasen Dajana Shabani dhe më pas me shtetasen Iva Aliko. Sipas saj ka krijuar një mardhënie marketingu me Hermesin i cili do të publikonte në rrejtet sociale restorantin e saj dhe në këmbim do të përfitonte drekë ose ndonjë pije falas. Johana

sqaron se në tre raste Hermesi ka sjellë klientë në lokal, por për shkak se Hermesi ka filluar të shkoj shpesh në restorant i shoqëruar nga persona të tjeër duke përfutur ushqim falas, Johana ka vendosur të mos shkoj më aty. Në deklarin e saj shtetasia Johana Lluka nuk jep të dhëna të tejsa me interesë për hetimin.

Organi i akuzes ne perfundim te hetimit ka vendosur te marrë si te pandehur shtetasen **Anjeza Bena**, duke e akuzuar per vepren penale te “**Shfrytëzimi i prostitucionit**” parashikuar nga neni 114 paragrafi i dytë i K.Penal, shtetasen **Ana Sula, Ismail Zani, Armando Nushi, Denisa Neli, Artur Gjini, Blerta Duka**, duke i akuzuar per vepren penale te **’Prostitucionit**’ parashikuar nga neni 113 paragrafi i parë dhe paragrafi i dytë i Kodit Penal si dhe shtetasin **Hermes Nikaj**, duke e akuzuar per vepren penale te **’Shfrytëzimi i prostitucionit**” dhe **’Prostitucionit**’, te parashikuara nga nenet 114/2 dhe 113/1 te Kodit Penal dhe me kete akuza e ka derguar çeshtjen per gjykim.

Vepra penale dhe akuza në ngarkim të të pandehurve u provua në këtë gjykim me provat e administruara të ndodhura në këtë fashikull hetimor me provat shkresore si:

- 1- Procedimi penal 324 viti 2019; 14 (katërbëdhjetë) fletë.
- 2- Relacion përf. hetimeve procedimit penal 324/2019; 43 (dyzet e tre) fletë.
- 3- Informacion për ndalimin dhe arrestimin e shtetasve; 11 (njëmbëdhjetë) fletë.
- 4- Procesverbal i kapjes në flagrancë; 2 (dy) fletë.
- 5- Procesverbal i kqyrjes së vendit të ngjarjes; 2 (dy) fletë.
- 6- Procesverbal i kontrollit të vendeve; 2 (dy) fletë.
- 7- Procesverbal akt motivimi për ndalimin e të dyshuarit; 2 (dy) fletë.
- 8- Procesverbal për arrestimin në flagrancë; 1 (një) fletë.
- 9- Procesverbal ndaj të cilit zhvillohen hetime A.Sula; 4 (katër) fletë.
- 10- Procesverbal ndaj të cilit zhvillohen hetime A.Bena; 1 (një) fletë.
- 11- Procesverbal ndaj të cilit zhvillohen hetime A. Nushi; 1 (një) fletë.
- 12- Procesverbal personi që ka dijeni A.Rushiti; 2 (dy) fletë.
- 13- Proc. sekuestrimi sendesh A. Bena; 1 (një) fletë.
- 14- Proc. sekuestrimi sendesh A. Sula; 1 (një) fletë.
- 15- Proc. sekuestrimi sendesh A. Rushiti; 1 (një) fletë.
- 16- Proc. sekuestrimi sendesh A. Nushi; 2 (dy) fletë.
- 17- Proc. kqyrje aparati celular A. Bena; 10 (dhjetë) fletë.
- 18- Proc. kqyrje aparati celular A. Sula; 3 (tre) fletë.
- 19- Proc. kqyrje aparati celular A. Nushi; 1 (një) fletë.
- 20- Procesverbal kontrolli personal; copë 2 (dy), fletë 2 (dy).
- 21- Kqyrje sistemit TIMS dt. 04.11.2019; 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë.
- 22- Kqyrje sistemit TIMS dt. 31.10.2019; 24 (njëzet e katër) fletë.
- 23- Kqyrje sistemit TIMS dt. 21.10.2019; 7 (shtatë) fletë.
- 24- Kqyrje të dhënave në internet dt. 22.10.2019; 2 (dy) fletë.
- 25- Raport shërbimi i datës 29.10.2019; 3 (tre) fletë.
- 26- Informacion për arrestimin e shtetasve H.Nikaj, A. Gjini; 46 (dyzet e gjashtë) fletë.
- 27- Procesverbal i kapjes në flagrancë; 2(dy)fletë
- 28- Procesverbali i kqyrjes së vendit të ngjarjes; 2(dy)fletë
- 29- Procesverbali i deklarin nën hetim i sht.A.Gjini; 1(një) fletë
- 30- Procesverbali i të drejtave për sht. A. Gjini; 1(një)fletë
- 31- Procesverbali i arrestimit në flagrancë i sht. A. Gjini; 1(një)fletë
- 32- Procesverbali i kontrollit personal të sht.A. Gjini; 1(një)fletë
- 33- Procesverbali i deklarin nën hetim i sht.H.Nikaj; 1(një) fletë

- 34- Procesverbali i arrestimit në flagrancë i sht. H.Nikaj; 1(një)fletë
- 35- Procesverbali i kontrollit personal të sht.H. Nikaj; 1(një)fletë
- 36- Procesverbal i deklarimit nën hetim i sht.D.Neli; 4(katër) fletë
- 37- Procesverbali i të drejtave për sht. D.Neli; 1(një)fletë
- 38- Procesverbale seksuetro, sëbashku me provat materiale; copë 3(tre), fletë 3(tre).
- 39- Proces. kqyrjes së telefonave; copë 4(katër) fletë 65(gjashtëdhjetë e pesë)fletë.
- 40- Relacion për ecurie procedimi penal dt. 19.02.2020; 11 (njëmbëdhjet) fletë.
- 41- Proc. ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasit I.Zani; dt. 17.01.2020; 1 (një) fletë.
- 42- Procesverbal që ka dijeni shtetas M. Haxhia; dt. 20.01.2020; 3 (tre) fletë.
- 43- Procesverbal që ka dijeni shtetasit I.Abazi; dt. 29.01.2020; 2 (dy) fletë.
- 44- Procesverbal që ka dijeni shtetasit E. Jahelezi; dt. 30.01.2020; 3 (tre) fletë.
- 45- Procesverbal që ka dijeni shtetas K. Gorasi; dt. 30.01.2020; 4 (katër) fletë.
- 46- Procesverbal që ka dijeni shtetas K.Ndrecka; dt. 30.01.2020; 2 (dy) fletë.
- 47- Procesverbal që ka dijeni shtetasit D.Hysa; dt. 30.01.2020; 2 (dy) fletë.
- 48- Procesverbal që ka dijeni shtetasit O. Seitaj; dt. 31.01.2020; 3 (tre) fletë.
- 49- Procesverbal që ka dijeni shtetasit E. Karafili; dt. 02.02.2020; 3 (tre) fletë.
- 50- Procesverbal që ka dijeni shtetas M. Shurdha; dt. 03.02.2020; 3 (tre) fletë.
- 51- Proc. që ka dijeni shtetas D. Shabani (Deda); dt. 03.02.2020; 3 (tre) fletë.
- 52- Procesverbal që ka dijeni shtetas S.Hoxha; dt. 04.02.2020; 2 (dy) fletë.
- 53- Procesverbal që ka dijeni shtetasit A. Papa; dt. 04.02.2020; 2 (dy) fletë.
- 54- Procesverbal kqyrje telefoni H.Nikaj dt.20.01.2020; 6 (gjashtë) fletë.
- 55- Procesverbal kqyrje të dhënash QKB dt. 19.02.2020; 2 (dy) fletë.
- 56- Procesverbal kqyrje TIMS dt. 21.10.2019; 7 (shtatë) fletë.
- 57- Relacion për ecurie procedimi penal dt. 28.07.2020; 20 (njëzet) fletë.
- 58- Procesverbal që ka dijeni shtetas J.Lluka; dt. 28.07.2020; 2 (dy) fletë.
- 59- Procesverbal që ka dijeni shtetasit B.Simolla; dt. 27.07.2020; 3 (tre) fletë.
- 60- Procesverbal që ka dijeni shtetasit O. Bistri; dt. 05.06.2020; 2 (dy) fletë.
- 61- Procesverbal që ka dijeni shtetas A. Ruçi; dt. 02.06.2020; 2 (dy) fletë.
- 62- Proc. ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasit A. Ruçi; dt. 02.06.2020; 1 (një) fletë.
- 63- Procesverbal që ka dijeni shtetas A.Bramka; dt. 29.05.2020; 2 (dy) fletë.
- 64- Procesverbal që ka dijeni shtetas A. Beqiri; dt. 27.05.2020; 3 (tre) fletë.
- 65- Procesverbal që ka dijeni shtetas E.Kaja (Kokoneshi); dt. 20.05.2020; 3(tre) fletë.
- 66- Procesverbal që ka dijeni shtetas R.Kaja; dt. 19.05.2020; 2 (dy) fletë.
- 67- Procesverbal që ka dijeni shtetas A. Mete; dt. 18.05.2020; 2 (dy) fletë.
- 68- Procesverbal që ka dijeni shtetas L.Hamzi; dt. 20.05.2020; 2 (dy) fletë.
- 69- Proc. ndaj të cilit zhvill. hetime shtetasit A. Nushi; dt. 14.05.2020; 3 (tre) fletë.
- 70- Procesverbal që ka dijeni shtetas L.Tabaku; dt. 13.05.2020; 1 (një) fletë.
- 71- Procesverbal që ka dijeni shtetas L.Tabaku; dt. 14.05.2020; 2 (dy) fletë.
- 72- Procesverbal që ka dijeni shtetas A.Brahushaj; dt. 04.05.2020; 2 (dy) fletë.
- 73- Procesverbal që ka dijeni shtetas A.Muçobega; dt. 14.05.2020; 2 (dy) fletë.
- 74- Procesverbal që ka dijeni shtetas E.Vokrri; dt. 20.05.2020; 2 (dy) fletë.
- 75- Procesverbal që ka dijeni shtetas S.Mane; dt. 15.05.2020; 2 (dy) fletë.
- 76- Procesverbal që ka dijeni shtetas B.Duka; dt. 03.03.2020; 3 (tre) fletë.
- 77- Proc. ndaj të cilit zhvill. hetime shtetasit B.Duka; dt. 03.03.2020; 5 (pesë) fletë.
- 78- Procesverbal që ka dijeni shtetas A.Beqaj; dt. 03.02.2020; 3 (tre) fletë.
- 79- Procesverbal kqyrje TIMS dt.04.05.2020; 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë.3
- 80-Proc. kqyrje cel. H.Nikaj dt. 27.05.2020;219 (dyqind e nëntëmbëdhjetë) fletë.
- 81-Proc. kqyrje cel. A .Bena dt.03.06.2020; 290 (dyqind e nëntëdhjetë) fletë.
- 82-Proc.kqyrje cel. A.Bena dt.03.05.2020; 3 (tre) fletë.
- 83-Proc. ndaj te cilit zh.hetime A. Bena. datë 02.10.2020; 1(një fletë).

- 84-Procesverbal që ka dijeni E.Ponari; 2 (dy) fletë.
- 85-Raport shërbimi patrulla dt.22.10.2019; 1 (një) fletë.
- 86-Proc. kqyrje interneti QKB dt.28.07.2020; 6 (gjashtë) fletë.
- 87-Tabelë fotografike hotel Autostrada; 7 (shtatë) fletë.
- 88-Proc. ballafaqimi dt.11.12.2019; copë 2 (dy), fletë 4 (katër).
- 89-Procesverbal pyetjes personit arrestuar A. Gjini; 2 (dy) fletë.
- 90-Procesverbal ndaj të cilit zh.hetime H. Nikaj dt. 05.12.2019; 5 (pesë) fletë.
- 91-Kopje procesverbalit Q.K.P.V.Trafikimit; 1 (një) fletë.
- 92-DVR-R e markës Verbatim, Kërkesa 875; copë 1 (një).
- 93-CD-R e markës Maxell, K.137; copë 1 (një).
- 94-DVD-R e markës Verbatim, Kërk.794; copë 1 (një).
- 95-CD-R e markës Maxell, K1184; copë 1 (një).
- 96-DVD-R e markës Verbatim; copë 1 (një).
- 97-CD-R markës Maxell, K.268; copë 1 (një).
- 98-DVD-R e markës Verbatim, Kërk.742; copë 1 (një).
- 99-DVD-R e markës Maxell, Kërk.1322; copë 1 (një).
- 100-Cd-R e markës Digitec dt.09.11.2019 arrestimi; copë 1 (një).
- 101-DVD-R përgjimi nr.0696983895 dt. 19.06.2019 – 27.07.2019; copë 1 (një).
- 102-CD-R përgjimi nr.0696983895 dt.23.07.2019 deri në përfundim; copë 1 (një).
- 103-CD-R përgjimi nr.0696701171 04.11.2019 – 14.11.2019; copë 1 (një).
- 104-CD-R përgjimi nr.0696983895 dt.15.10.2019 – 04.11.2019; copë 1 (një).
- 105-DVD-R përgjimi nr.0696983895 dt. 04.11.2019 – 29.11.2019; copë 1 (një).
- 106-CD-R përgjimi nr.0696701171 dt.15.10.2019 – 04.11.2019; copë 1 (një).
- 107-CD-R përgjimi nr.0692571295 dt. 04.11.2019 – 29.11.2019; copë 1 (një).
- 108-DVD-R përgjimi nr.0692571295 dt. 15.10.2019 – 04.11.2019; copë 1 (një).
- 109-Raporte shërbimi dt. 14,15,18-20.02.2019 dhe 25.02.2019; 9 (nëntë) fletë.
- 110-Rap.shërbimi dt. 18-20.03.2019, 22-27.03.2019, 29.03.2019; 12 (dymbëdhjetë) fletë.
- 111-Raporte shërbimi dt. 22-27.06.2019; 11 (njëmbëdhjetë) fletë.
- 112-Raporte shërbimi dt 01-07.07.2019 dhe 09-10.07.2019; 13 (trembëdhjetë) fletë.
- 113-Rap. shërbimi dt. 15.07.2019 deri 03.08.2019; 30 (tridhjetë) fletë.
- 114-Raporte shërbimi dt. 15 - 26.10.2019; 15 (pesëmbëdhjetë) fletë.
- 115-Raport shërbimi dt. 27.10.2019 – 23.11.2019; 41 (dyzet e një) fletë.
- 116-Proces. transkriptim nr. 0692571295 dt.21.11.2019; 35 (tridhjet e pesë) fletë.
- 117-Proces. transkriptim nr. 0692571295 dt.18.12.2019; 6 (gjashtë) fletë.
- 118-Proces. transk. nr. 0696983895 dt.05.08.2019; 66 (gjashtëdhjet e gjashtë) fletë.
- 119-Proces. transkriptim nr. 0696983895 dt.13.08.2019; 6 (gjashtë) fletë.
- 120-Proces. transkriptim nr. 0696983895 dt.02.09.2019; 24 (njëzet e katër) fletë.
- 121-Proces. transkriptim nr. 0696983895 dt.21.11.2019; 31 (tridhjet e një) fletë.
- 122-Proces. transkriptim nr. 0696983895 dt.23.12.2019; 53 (pesëdhjet e tre) fletë.
- 123-Proces. transkriptim nr. 0696701171 dt.18.12.2019; 9 (nëntë) fletë.
- 124-Proces. transkriptim nr. 0696701171 dt.26.11.2019; 29 (njëzet e nëntë) fletë.
- 125-Kërkësë vlerësimi arrestit flagrancë dt.26.11.2019; 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë.
- 126-Vendim rregjistrimi emrit personit H.Nikaj, A. Gjini, D. Neli, dt.25.11.2019; 6 fletë.
- 127-Kërkësë caktimi masës sigurisë shtetasit H.Nikaj; 4 (katër) fletë.
- 128-Shkurtim vendimi nr. 2625/1 akti dt.12.12.2019 H.Nikaj; 1 (një) fletë.
- 129-Shkurtim Vendimi nr. 2526 akti datë 12.11.2019 A. Ben; 1 (një) fletë.
- 130-Vendim nr.2526 dt.12.11.2019 caktimi m.sigurisë shtetasës A.Bena; 21 (njëzet e një) fletë.
- 131-Shkr.nr.346/1 datë 23.04.2020 e Gjykatës Apelit Tiranë; 5 (pesë) fletë.
- 132-Shkr.nr.prot.5400 dt.14.05.2020 Ankim vendimit 677 akti dt.13.05.2020; 7 (shtatë)

fletë.

133-Vendim rregjistrimi emrit të personit 09.11.2019 A.Bena, A.Sula, A.Nushi; 13 fletë.

134-Ankim kundër vendimit nr.2526 dt.12.11.2019; 23 (njëzet e tre) fletë.

135-Vendim gjykate lejim përgjimi nr.60 akti datë 19.06.2019; 2 (dy) fletë.

136-Vendim gjykate lejim përgjimi nr. 60/1 akti dt.04.07.2019; 2 (dy) fletë.

137-Vendim gjykate lejim përgjimi nr. 60/2 akti dt.19.07.2019; 5 (pesë) fletë.

138-Vendim gjykate lejim përgjimi nr. 93 akti dt.15.10.2019; 21 (njëzet e një) fletë.

139-Vendim gjykate zgjatje përgjimi nr. 93/1 akti dt.30.10.2019; 6 (gjashtë) fletë.

140-Vendim gjykate zgjatje përgjimi nr. 93/2 akti dt.14.11.2019; 4 (katër) fletë.

141-Autorizim përgjimi vëzhgim, filmim, dt. 11.02.2019; 2 (dy) fletë.

142-Autorizim përgjimi vëzhgim, filmim, dt. 15.03.2019; 2 (dy) fletë.

143-Autorizim përgjimi vëzhgim, filmim, dt. 19.06.2019; 2 (dy) fletë.

144-Autorizim përgjimi vëzhgim, filmim, dt. 03.07.2019; 2 (dy) fletë.

145-Autorizim përgjimi vëzhgim, filmim, dt. 19.07.2019; 2 (dy) fletë.

146-Autorizim përgjimi vëzhgim, filmim, dt. 14.10.2019; 2 (dy) fletë.

147-Autorizim përgjimi vëzhgim, filmim, dt. 29.10.2019; 2 (dy) fletë.

148-Autorizim përgjimi vëzhgim, filmim, dt. 13.11.2019; 2 (dy) fletë.

149-Procesverbal dkqyrje sendi CD dt.27.04.2020 FRS/1205/LP dt.08.04.2020 Vodafone  
SHA;

bashkëlidhur CD.

150-Procesverbal dkqyrje sendi CD dt.05.06.2020 FRS/1585/LP dt.26.05.2020 Vodafone  
SHA;

79 fletë, bashkëlidhur CD.

151-Kërkesë lejim përgjimi nr.telefonik dt.18.06.2019; 5 (pesë) fletë.

152-Kërkesë zgjatje afatit përgjimi telefonik dt. 03.07.2019; 5 (pesë) fletë.

153-Kërkesë zgjatje afati përgjimi telefonik dt. 18.07.2019; 6 (gjashtë) fletë.

154-Kërkesë lejimi përgjimi nr.telefonik dt. 14.10.2019; 38 (tridhjet e tetë) fletë.

155-Kërkesë zgjatje afati përgjimit dt. 30.10.2019; 10 (dhjetë) fletë.

156-Kërkesë zgjatje afati përgjimit dt. 13.11.2019; 8 (tetë) fletë.

157-Shkresë e Prokurorisë Përgjithshme nr.prot.936 dt.05.11.2019 sëbashku me  
procesverbal

realizim përgjimit dt.05.11.2019; 2 (dy) fletë.

158-Shkresë e Prokurorisë Përgjithshme nr.prot.666 dt.24.07.2019 sëbashku me  
procesverbal

realizim përgjimit dt.24.07.2019; 2 (dy) fletë.

159-Shkresë e kompanisë Vodafone FRS/1820/LP dt.05.06.2020 sëbashku me cd;1 cop.

160-Shkresë e kompanisë Albtelecom SHA nr.1168/1 dt.06.06.2020 sëbashku me cd;  
copë 1.

161-Shkresë e kompanisë Telecom Albania SHA nr. 1952/1 dt.23.06.2020 sëbashku me  
cd; 1

cop

162-Shkresë e kompanisë Telecom Albania SHA nr. 1241/1 dt.22.04.2020 sëbashku me  
cd;1 cop

163-Shkresë e kompanisë Albtelecom SHA nr. 1886/1 dt.15.05.2020 sëbashku me cd; 1  
cop.

164-Shkresë e kompanisë Vodafone FRS/3107/ES dt.13.09.2019 sëbashku me cd; copë 1  
(një).

165-Proces. kqyrje sendi dt.17.09.2019, cd Vodafone nr. FRS/3107/ES; 5 (pesë) fletë.

166-Procesverbal kqyrje sistemit TIMS dt.27.04.2019; 11 (njëmbëdhjetë) fletë.

167-Procesverbal kqyrje sistemit TIMS dt.12.11.2019; 2 (dy) fletë.

-Si dhe ne teresi fashikulli i procedimit penal me nr. 324 te vitit 2019

Nga analiza e provave të administruara nga ana e gjykates arrihet në përfundimin se të pandehurit kanë kryer plotësisht veprën penale për të cilën akuzohen në mënyrë respektive.

**Neni 113, Prostitucioni**(*Shtuar me ligjin nr. 23/2012, datë 1.3.2012, neni 12*)

*-Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*

*-Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me*

*burgim gjer në tre vjet.*

**Neni 114, Shfrytëzimi i prostitucionit** (Ndryshohet titulli dhe shfuqizohet paragrafi II me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998, neni 2; ndryshuar me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, neni 28)

*-Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.*

*-Po kjo vepër, kur kryhet me të mitur, ndaj disa personave, me persona me të cilët ekzistojnë*

*lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, apo duke përfituar nga raportet zyrtare, ose kryhet në*

*bashkëpunim apo më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuara me funksione shtetërore dhe publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*

Nga sa më lart rezulton tërësisht e provuar se të pandehurit kanë konsumuar tërësisht veprat penale të "Prostitucionit" parashikuar nga neni 113 paragrafi i parë dhe paragrafi i dytë i Kodit Penal si dhe veprën penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" parashikuar nga neni 114 paragrafi i dytë i K.Penal.

Nga analiza e të gjitha provave të administruara në këtë procedim rezulton e provuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale të sipercituara.

Gjykata në shqyrtimin që u bëri akteve të ndodhura në fashikullin e procedimit penal, krijon bindjen se të pandehurit Anjeza Bena dhe Hermes Nikaj kanë konsumuar veprat penale të « Shfrytëzimi i prostitucionit », parashikuar nga neni 114 paragrafi i dytë i K.Penal dhe i pandehuri Hermes Nikaj dhe veprën penale të " Prostitucionit ", ndërsa të pandehurit e tjerë rezultoi gjatë gjykimit se kanë konsumuar veprën penale të " Prostitucionit ".

**1-Mbrojtja e të pandehures Anjeza Bena**, av. Baftjar Rusi paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton në dosje dhe si përfundim kërkoj gjykates:

- që të aplikohet si masë denimi për të pandehuren minimum i dispozites penale të sanksionuar në nenin 114 të K.Penal dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal mbi masën e denimit.

**2- Mbrojtja e të pandehures Ana Sula**, av. Andi Hasanaj paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton në dosje dhe si përfundim kërkoj gjykates;

- një masë denimi sa më të butë, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik, bazuar kjo në nenin 63 të K.Penal.

**3- Mbrojtja e të pandehurit Ismail Zani**, av. Agron Kalemaj paraqet me shkrim

konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;  
- ne aplikim te nenit 388/d te K.Pr.Penale, deklarimin e pafajshem te te pandehurit Ismail Zani pasi nuk provohet qe i pandehuri te kete kryer vepren penale ose ne alternative te ketij denimi ne rast se gjykata e gjen fajtor denimi me gjob ne masen 100.000 leke.

4- **Mbrojtja e te pandehurit Armando Nushi**, av.Olta Pema, paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;  
- deklarimin e pafajshem te shtetasit Armando Nushi , ne alternative te denimit kerkojme denimin e tij me gjobe ne nje mase te cmuar nga gjykata.

5- **Mbrojtja e te pandehurit Hermes Nikaj** av.Perlat Kocillari , paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;  
-bazuar ne nenin 388/1,d te K.Pr.Penale pafajsi per te pandehurin Hermes Nikaj pasi nuk provohet se ai ka kryer veprat penale per te cilat akuzohet, ne rast se nuk pranohet kerkojme aplikimin e Nenit te 59 te K.Penal.

6- **Mbrojtja e te pandehures Denisa Neli**, av.Edvis Gorishti paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;  
- kerkon nje mase me te bute.

7- **Mbrojtja e te pandehures Artur Gjini**, av.Entela Hyseni paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;  
-denimin e te pandehurit me nje gjobe minimale, ose ne alternative denimin e tij ne nje mase minimale me burg dhe te aplikojme nenin 63 te K.Penal per pjesen e pavuajtur te denimit me burg duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me burgim per Artur Gjini dhe zevendesimin e tij duke kryer nje pune ne interes public.

8- **Mbrojtja e te pandehures Blerta Duka**, av.Aldor Hysenlikaj, paraqet me shkrim konkluzionet e fundit, i lexon e depoziton ne dosje dhe si perfundim kerkoj gjykates;  
- kerkon pezullimin e denimit duke aplikuar nenin 59 te K.Penal dhe venien e tij ne prove.

Nga çmuarja e faktit si me siper gjykata konkludon se te pandehurit duhet te deklarohen fajtor per veprat penale te kryera prej tyre, te parashikuara nga neni 113/1,113/2,114/2 i Kodit Penal.

Në kushtet kur vlerësohet se te pandehurit, gjenden si subjekt i konsumimit nga ana e tyre të kësaj figure vepre penale për të cilën akuzohet, ata duhet te deklarohen fajtor dhe per kete shkak duhen denuar.

Në kërkesën për llojin dhe caktimin e dënimit për të pandehurit gjykata mban parasysh këto rrethana lehtësuese dhe rënduese të parashikuara në nenet 48, 49 dhe 50 të K.Penal:

-Rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale në përputhje me sanksionin ( burgim nga një vit deri në pesë vjet) dhe fenomenin që krijon një veprim i tillë ,

-Rrezikshmërinë e të pandehurit, e cila çmoj që është relativisht e ulët për shkak të qënies rrëthanave në të cilat ai ka qenë i detyruar të kryejë një veprim të tillë ,

-Shkallën e fajit, në formën e dashjes së drejtpërdrejtë,

-Qëndrimin pohues dhe pendimin e thellë të shprehur në gjykim,

-Gjendjen gjyqësore – i padënuar sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore dt. 24.05.2019 të administruar në fashikull,

• Faktin qe vepra penale e kryer ka cenuar marredheniet juridike te vendosura per te garantuar individin te mbrojtur me Kushtetute dhe posacerisht nga legjislacioni penal.

- Faktin që te pandehurit **jane te padenuar më parë** për vepra të ndryshme penale.
- Rrethanat në të cilën është kryer vepra penale si dhe pasojat e ardhura nga vepra penale.
- Pendimin e thelle te te pandehurve per veprimin e kryer nga ana e tij.
- Moshen e re te pandehurve.
- Gjithashtu, në masën e dënimit Gjykata, duhet te kete parasysh dhe faktin, që ajo duhet të jetë në përshtatshmëri, jo vetëm me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit të saj, por dhe që të jetë e tillë **që të vlejë për reabilitimin e te pandehurve.**

Sa më sipër gjykata duke u bazuar në Nenin 114/2 të Kodit Penal çmon se e pandehura **Anjeza Bena**, duhet te deklarohet fajtores per vepren penale te “Shfrytëzimi i prostitucionit”, te parashikuar nga Neni 114/2 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dënimin e saj me **7(shtate) vjet burgim**. Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **4(kater) vjet e 8(tete) muaj burgim**. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim(**per pjesen e pavuajtur**) si dhe detyrimin që e pandehura të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **3 ( tre) vjet**, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale.

E pandehura **Ana Sula**, duhet te deklarohet fajtores per vepren penale te “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e saj me **3( tre ) muaj burgim**. Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **2( dy) muaj burgim**. Bazuar ne nenin **63 te K.Penal**, pezullimin e ekzekutimit te vendimit te denimit me burgim, duke e zvendesuar me **90 ore pune** ne interes publik prane Njesia Administrative. Puna ne interes publik te kryhet brenda nje afati prej **6(gjashte) muajsh** duke u detyruar i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves.

I pandehuri **Ismail Zani**, duhet te deklarohet fajtor per vepren penale te “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal, dënimin e tij me **6( gjashtë ) muaj burgim**. Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **4 (katër ) muaj burgim**. Bazuar ne nenin **63 te K.Penal**, pezullimin e ekzekutimit te vendimit te denimit me burgim, duke e zvendesuar me **120 ore pune** ne interes publik prane Njesia Administrative. Puna ne interes publik te kryhet brenda nje afati prej **6(gjashte) muajsh** duke u detyruar i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves.

I pandehuri **Armando Nushi**, duhet te deklarohet fajtor per vepren penale te “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal, dhe dënimin e tij me **150 000(njeqinde pesedhete mije) leke gjobe**. Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **100 000(njeqindmije) leke gjobe**. Në zbatim të nenit 34 te K.Pr.penale, shlyerja e gjobes Brenda nje afat prej **6 muajve** duke filluar ky afat nga e nesermja e marrjes vendimit forme te prere.

I pandehuri **Hermes Nikaj**, duhet te deklarohet fajtor per vepren penale te “Shfrytëzimi i prostitucionit” parashikuar nga neni 114/2 i K.Penal, dënimin e tij me **7 vjet burgim**. Deklarimin fajtor **të të pandehurit Hermes Nikaj**, për veprën penale “Prostitucioni” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e tij me **6( gjashtë ) muaj burgim**. Në aplikimin e nenit 55 të Kodit Penal bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm duke e dënuar me **7 (shtate) vjet burgim**. Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **4 ( kater) vjet e**



**8(tete) muaj burgim.** Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim(**per pjesen e pavuajtur**) si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **3 ( tre) vjet** , me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale. Shuarjen e masës së sigurimit atë të “Arrestit në shtëpi”, të dhënë me vendimin nr.677, datë 13.05.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

E pandehura **Denisa Neli**, duhet të deklarohet fajtoresh për veprën penale të “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e saj me **3 ( tre) muaj burgim**. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **2 ( dy) muaj burgim**. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **4 (kater) muaj**, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.

I pandehuri **Artur Gjini**, duhet të deklarohet fajtor për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal, dënimin e tij me **6 ( gjashtë ) muaj burgim**. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **4 ( katër ) muaj burgim**. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **8 (tetë) muaj** , me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.

E pandehuri **Blerta Duka**, duhet të deklarohet fajtoresh për veprën penale të “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e saj me **3 (tre) muaj burgim**. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **2 ( dy ) muaj burgim**. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që e pandehura të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **4 (kater) muaj**, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.

- Në lidhje me të pandehurit Hermes Nikaj dhe Anjeza Bena, Gjykata duke patur parasysh qëndrimin pohues të dy të pandehurve, si dhe qëndrimin bashkepunues të tyre, duke pasur parasysh që e pandehura Anjeza Bena është e padënuar me parë, kryefamiljare dhe tregoi pendim të thellë për gjykatën, duhet pezulluar dënimi i saj me burgim, duke ja pezulluar dënimin dhe duke i caktuar një dënim me kusht që të mbajë kontakt me Shërbimin e Proves.

- Edhe persona i përket të pandehurit Hermes Nikaj, duke pasur parasysh që ky i pandehur ka qenë për një periudhë relativisht të gjatë me masë sigurimi arrest në burg, Gjykata krijon bindjen se duhet pezulluar dënimi me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit duke pasur parasysh moshën e tij të re, qëndrimin e tij bashkepunues dhe pohues gjatë gjyqimit.

Në këtë aspekt, gjykata ka në konsideratë qëndrimin e të pandehurve ndaj veprave penale, mënyrën e realizimit të saj, nivelin arsimor, gjendjen ekonomiko-familjare si dhe personalitetin e të pandehurve.

Duke qënë se të pandehurit u deklaruan fajtor dhe u dënuan për veprat penale për të cilat akuzohen bazuar në Nenin 485 të Kodit Procedurash Penale të pandehurit duhet të paguajë shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga shteti.

**Per ç'ka dhe si u arsyetua me siper  
duke u bazuar edhe ne Nenin 113/1,113/2,114/2 te Kodit Penal  
Nenet: 379, 380, 381, 382, 383, 384, 390, 393 te K.Pr.Penale**

**V E N D O S I**

**1-Deklarimin fajtores të të pandehurës Anjeza Bena, për veprën penale “Shfrytëzimi i prostitucionit” parashikuar nga neni 114/2 i K.Penal, dënimin e saj me **7(shtate) vjet burgim.****

- Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **4(kater) vjet e 8(tete) muaj burgim.**

-Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim(**per pjesen e pavuajtur**) si dhe detyrimin që e pandehura të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **3 ( tre) vjet** , me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprën tjetër penale.

**2-Deklarimin fajtor të të pandehurës Ana Sula, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e saj me **3( tre ) muaj burgim.****

- Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **2 ( dy ) muaj burgim.**

- Bazuar ne nenin **63 te K.Penal**, pezullimin e ekzekutimit te vendimit te denimit me burgim, duke e zvendësuar me **90 ore pune** ne interes publik prane Njesia Administrative.

-Puna ne interes publik te kryhet brenda nje afati prej 6(gjashte) muajsh duke u detyruar i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves

**3-Deklarimin fajtor të të pandehurit Ismail Zani, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal, dënimin e tij me **6( gjashtë ) muaj burgim.****

- Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **4 (katër ) muaj burgim.**

- Bazuar ne nenin **63 te K.Penal**, pezullimin e ekzekutimit te vendimit te denimit me burgim, duke e zvendësuar me **120 ore pune** ne interes publik prane Njesia Administrative.

-Puna ne interes publik te kryhet brenda nje afati prej **6(gjashte) muajsh** duke u detyruar i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves

**4-Deklarimin fajtor të të pandehurit Armando Nushi, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal, dënimin e tij me **150 000(njeqind e pesedhjete mije) leke gjobe****

- Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **100 000(njeqindmije) leke gjobe.**

-Në zbatim të nenit 34 te K.Pr.penale, shlyerja e gjobes Brenda nje afat prej **6 muajve** duke filluar ky afat nga e nesermja e marrjes vendimit forme te prere.

**5-Deklarimin fajtor të të pandehurit Hermes Nikaj, për veprën penale “Shfrytëzimi i prostitucionit” parashikuar nga neni 114/2 i K.Penal, dënimin e tij me **7 vjet burgim.****

-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Hermes Nikaj**, për veprën penale “Prostitucioni ” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e tij me **6( gjashtë ) muaj**

**burgim.**

-Në aplikimin e nenit 55 të Kodit Penal bashkë me dënimeve në një dënim të vetëm duke e dënuar **me 7 (shtate) vjet burgim.**

- Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **4 (kater) vjet e 8(tete) muaj burgim.**

-Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim(**per pjesen e pavuajtur**) si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **3 ( tre) vjet** , me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.

-Shuarjen e masës së sigurimit atë të “Arrestit në shtëpi”, të dhënë me vendimin nr.677, datë 13.05.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6-Deklarimin fajtor të të pandehurës **Denisa Neli**, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e saj me **3 ( tre) muaj burgim.**

-Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **2 ( dy) muaj burgim.**

-Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **4 (kater) muaj**, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.

7-Deklarimin fajtor të të pandehurit **Artur Gjini**, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/2 i K.Penal, dënimin e tij me **6 ( gjashtë ) muaj burgim.**

- Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **4 ( katër ) muaj burgim.**

-Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **8 (tetë) muaj** , me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale .

8-Deklarimin fajtor të të pandehurës **Blerta Duka**, për veprën penale “Prostitucionit” parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal, dënimin e saj me **3 (tre) muaj burgim.**

- Ne aplikim te nenit 406 të K.Pr.Penale, duke e ulur dënimin me një të tretën dhe dënuar përfundimisht me **2 ( dy) muaj burgim.**

-Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim si dhe detyrimin që e pandehura të mbajë kontakte me shërbimin e provës duke u vënë në provë me një afat prove prej **4 (kater) muaj**, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë veprë tjetër penale.

9-Në bazë të nenit 190/1 i Kodit të Procedurës Penale provat materiale të sekuestruara të azgjeshohen.

-Shpenzimet procedurale të hetimit paraprak dhe ato të gjyqimit, t'i ngarkohen të pandehurve.

-Shpjegohet e drejta e ankimit sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Tiranë nga dita e komunikimit të vendimit;

-**Tirane me dt.28.07.2021**

**GJYQTAR**

**GJYQTARE**

**GJYQTAR**

**SOKOL TONA**

**ARDIANA BERA**

**ARBEN MICKAJ**

**SEKRETARE  
MERITA DRISHTI**

Shpenzimet hetimore

12000 leke

Shpenzime paraprake

150 leke

Shpenzime gjyqesore

Njoftime 10x150 leke